



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 93

Tiranë – E mërkurë, 1 qershor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 375, datë 25.5.2016	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve..... 5231
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 381, datë 25.5.2016	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Kristo Tile..... 5236
Urdhër i ministrit të Financave nr. 64, datë 23.5.2016	Për delegim kompetencash..... 5237
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 26, datë 19.5.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr. 00-2015-1293, datë 11.6.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr. 850, datë 18.12.2014, të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 247, datë 10.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë..... 5237
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 27, datë 19.5.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2014-3734 (712), datë 18.12.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë..... 5239
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 28, datë 19.5.2016	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit nr. 1178, datë 18.9.2014, të Gjykatës Administrative të Rrethit Gjyqësor Durrës, brenda një afati të arsyeshëm..... 5246
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 29, datë 19.5.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2015-2989 (304), datë 14.5.2015, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë..... 5251
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 30, datë 19.5.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 62, datë 11.2.2015, të Gjykatës së Lartë. Pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 62, datë 11.2.2015, të Gjykatës së Lartë..... 5255

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 31, datë 23.5.2016	Me objekt shfuqizimin pjesërisht si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 2080, datë 23.3.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 792, datë 15.4.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2011-296, datë 6.4.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi); nr. 00-2014-18, datë 15.1.2014, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).....	5263
Vendim i Gjykatës Lartë nr. 1, datë 29.2.2016	Me objekt anulimin pjesërisht të aktit administrativ, urdhrit nr. 319/8, datë 24.11.2006, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “Inspektor”, paditësit Polikron Zyba. Anulimin pjesërisht të aktit administrativ, urdhrit nr. 142, datë 22.1.2007, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “inspektor”, paditësit Polikron Zyba. Anulimin pjesërisht të aktit administrativ, urdhrit nr. 142/1, datë 10.12.2007, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “inspektor”, paditësit Polikron Zyba. Anulimin pjesërisht të aktit administrativ, urdhrit nr. 732/1, datë 25.3.2008, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “inspektor”, paditësit Polikron Zyba. Anulimin pjesërisht të aktit administrativ, urdhrit nr. 5290/1, datë 7.9.2011, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “nënkomisar”, paditësit Polikron Zyba. Anulimin pjesërisht të aktit administrativ, urdhrit nr. 43, datë 17.6.2008, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “n/inspektor”, paditësit Polikron Zyba. Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, t’i njohë paditësit Polikron Zyba gradën policore “komisar” dhe të gjitha të drejtat që rrjedhin nga kjo gradë, nga data 17.6.2008 e në vijim.....	5267
	Vendim <i>(i shkurtuar)</i> për shpalljen të zhdukur të shtetasit Naxhi Caca.....	5282
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Dhimitraq Zguro.....	5282

**VENDIM****Nr. 375, datë 25.5.2016**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES,
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR
NXITJEN DHE MBROJTJEN E
INVESTIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI**Niko Peleshi****MARRËVESHJE**

**NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR NXITJEN
DHE MBROJTJEN E INVESTIMEVE**

Hyrje

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, *duke dëshiruar* intensifikimin e bashkëpunimit ekonomik në interesin e përbashkët të të dyja Shteteve,

duke synuar të krijojnë dhe ruajnë kushte të favorshme për investime nga investitorët e njërës Palë Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese,

duke njoftur nevojën për të nxitur dhe mbrojtur investimet e huaja, me qëllim nxitjen e prosperitetit ekonomik dhe zhvillimin e qëndrueshëm të të dyja shteteve,

të bindur se këta objektiva mund të arrihen pa lehtësuar standardet e zbatimit të përgjithshëm mbi shëndetin, sigurinë, punën dhe mjedisin,

duke synuar të inkurajojnë investitorët për respektimin e standardeve dhe parimeve të pranuar ndërkombëtarisht mbi përgjegjësitë shoqërore të korporatave,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1**Përkufizimet**

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

1. Termi “investim” nënkupton çdo lloj pasurie të krijuar ose fituar nga një investitor i njërës Palë Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, i cili ka karakteristika të tilla si zotimin e kapitalit apo burimeve të tjera, pritshmëritë mbi të ardhurat ose fitimin, ose supozimin e rrezikut, duke përfshirë:

a) pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të drejtat e tjera të lidhura, të tilla si servitute, hipoteka, garanci dhe pengje;

b) një shoqëri ose aksione, pjesë ose çfarëdolloj tjetër të pjesëmarrjes në një shoqëri;

c) pretendimet për paratë ose çfarëdo performancë që ka një vlerë ekonomike, me përjashtim të pretendimeve për para që rrjedhin vetëm nga kontratat tregtare për shitjen e mallrave dhe shërbimeve;

d) të drejtat e pronësisë intelektuale, të drejtat e pronësisë industriale (të tilla si: patentat, dizenjet ose modelet industriale, markat tregtare ose të shërbimit, emrat tregtarë, treguesit e origjinës), ekspertiza dhe vullneti i mirë;

e) të drejtat e dhëna në bazë të ligjit, kontratës ose vendimit të një autoriteti si koncesionet, licencat, autorizimet dhe lejet.

Termi “investim” do të zbatohet, gjithashtu, për “të ardhurat” e mbajtura për qëllim të riinvestimit dhe të ardhurat nga “likuidimi” siç këta terma përkufizohen më poshtë.

Ndryshimi në formën në të cilën pasuritë janë investuar ose riinvestuar nuk ndikon në karakterin e tyre si investime.

2. Termi “investitor” u referohet të dyja Palëve Kontraktuese, për:

a) Një person fizik, që merr statusin si shtetas i një Pale Kontraktuese, në pajtim me ligjet e saj në fuqi;



b) Një person juridik, duke përfshirë shoqëritë, korporatat, shoqatat e biznesit dhe organizata të tjera, të cilat themelohen apo janë të organizuara në mënyrë të rregullt sipas ligjit të asaj Pale Kontraktuese dhe kanë selinë e tyre, së bashku me aktivitetet reale ekonomike, në territorin e kësaj Pale Kontraktuese;

c) Një person juridik jo i krijuar sipas ligjit të asaj Pale Kontraktuese por në pronësi apo i kontrolluar në mënyrë efektive nga një person fizik siç përcaktohet në pikën “a” më sipër ose nga një person juridik siç përcaktohet në pikën “b” më sipër.

3. Termi “të ardhura” nënkupton shumat e fituara nga një investim dhe përfshin në veçanti fitimet, interesin, fitimet kapitale, dividendët, honorarët, ose tarifa dhe pagesa të tjera, duke përfshirë pagesat në natyrë.

4. Termi “territor” nënkupton:

a) në lidhje me Republikën e Shqipërisë nënkupton territorin nën sovranitetin e Republikës së Shqipërisë që përfshin ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si dhe çdo zonë përtej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, mbi të cilën Republika e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin e saj dhe me të drejtën ndërkombëtare ushtron të drejtat e saj sovrane ligjore;

b) në lidhje me Republikën e Kosovës nënkupton territorin mbi të cilin ka juridiksion ose të drejta sovrane në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të drejtën ndërkombëtare.

Neni 2

Objekti i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje zbatohet për investimet në territorin e njëres Palës Kontraktuese të krijuara ose të fituara në përputhje me ligjet dhe rregulloret e saj nga investitorët e Palës tjetër Kontraktuese, qoftë para apo pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë, kjo Marrëveshjeje nuk zbatohet për pretendimet apo mosmarrëveshjet që rrjedhin nga ngjarjet që kanë ndodhur para hyrjes së saj në fuqi.

Neni 3

Nxjitja, pranimi

1. Secila Palë Kontraktuese do të nxisë në territorin e saj, sa më shumë që të jetë e mundur, investimet nga investitorët e Palës tjetër

Kontraktuese dhe i pranon këto investime në përputhje me ligjet dhe rregulloret e saj.

2. Kur një Palë Kontraktuese pranon një investim të kryer në territorin e saj, ajo siguron në përputhje me ligjet dhe rregulloret e saj, të gjitha lejet ose autorizimet e nevojshme në lidhje me një investim të tillë, duke përfshirë autorizimet e nevojshme për aktivitetet e personelit menaxherial dhe teknik të përzgjedhur nga investitori.

3. Secila Palë Kontraktuese publikon apo i vë në dispozicion publikut, pa vonesë, ligjet dhe rregulloret e saj, si dhe marrëveshjet ndërkombëtare, të cilat mund të cenojnë investimet e investitorëve të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 4

Trajtimi kombëtar dhe trajtimi i kombit më të favorizuar

1. Secila Palë Kontraktuese do të sigurojë një trajtim të drejtë, të barabartë dhe transparent të investimeve të investitorëve të Palës tjetër Kontraktuese.

2. Asnjë Palë Kontraktuese nuk do të ofrojë në territorin e saj për investimet e investitorëve ekzistues apo të rinj të Palës tjetër Kontraktuese, një trajtim më pak të favorshëm sesa ai që u ofron investimeve të investitorëve të vet ose investimeve të investitorëve të një shteti të tretë, cilitoqoftë më i të favorshëm për investitorët në fjalë.

3. Asnjë Palë Kontraktuese nuk do të ofrojë në territorin e saj për investitorët e Palës tjetër Kontraktuese, për sa i përket menaxhimit, mirëmbajtjes, gëzimit, përdorimit ose disponimit të investimit të tyre, një trajtim i cili është më pak i favorshëm sesa ai që ai u ofron investitorëve të vet ose investitorëve të një shteti të tretë, cilito është më i favorshëm për investitorët në fjalë.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, nuk duhet të interpretohet në mënyrë që të detyrojnë një Palë Kontraktuese t'u japë investitorëve të Palës tjetër Kontraktuese përfitimet e një trajtimi, preference apo privilegj që rrjedh nga ish-Pala Kontraktuese, nga:

a) çdo bashkim doganor ekzistues apo i ardhshëm, ose bashkim ekonomik, zonë e tregtisë së lirë apo marrëveshje të ngjashme ndërkombëtare;

b) çdo marrëveshje ndërkombëtare apo marrëveshje apo legjislacion i brendshëm, i lidhur tërësisht ose pjesërisht me tatimin.



Neni 5

Shpronësimi dhe kompensimi

1. Asnjëra Palë Kontraktuese nuk do të shpronësojë, shtetëzojë ose ndërmarrë masa që kanë efekt të njëjtë (më poshtë i referuar si “shpronësim”) kundër investimeve të investitorëve të Palës tjetër Kontraktuese, përveç nëse:

a) Ky shpronësim është në interes të publikut dhe sipas një procesi të rregullt ligjor;

b) Ky shpronësim kryhet mbi baza jodiskriminuese; dhe

c) Jepet kompensim i menjëhershëm, i përshtatshëm dhe efektiv.

2. Kompensimi i përmendur në pikën “c” të paragrafit 1 të këtij neni do të jetë i barasvlershëm me vlerën e tregut të investimit të shpronësuar, menjëherë para shpronësimit apo kur shpronësimi i afërt është bërë i njohur për publikun, cilito që ndodh më herët, dhe duhet të paguhet pa vonesë të papërshtatshme. Kompensimi duhet të përfshijë interesin e llogaritur mbi bazën LIBOR nga data e shpronësimit deri në datën e pagesës së plotë.

3. Investitorët, asetet e të cilëve janë duke u shpronësuar duhet që, pa cenuar të drejtat e tyre sipas nenit 8 të kësaj Marrëveshjeje, të gëzojnë të drejtën për shqyrtim të menjëhershëm nga autoritetet përkatëse gjyqësore ose autoritetet e tjera kompetente dhe të pavarura të Palës Kontraktuese shpronësuese për të përcaktuar nëse shpronësimi i tillë, dhe çdo kompensim i ndërlidhur pajtohet me parimet e këtij neni dhe ligjet dhe rregulloret e Palës Kontraktuese për shpronësim.

Neni 6

Kompensimi për dëmtime ose humbje

1. Një investitor i një Pale Kontraktuese që ka pësuar humbje në lidhje me investimin e tij në territorin e Palës tjetër Kontraktuese për shkak të luftës ose një konflikti tjetër të armatosur, gjendjes së jashtëzakonshme, revolucionit, kryengritjes, trazirave civile apo çdo ngjarjeje tjetër të ngjashme në territorin e kësaj Pale Kontraktuese duhet t'i jepet nga kjo Palë Kontraktuese për sa i përket kthimit, zhdëmtimit, kompensimit ose ndonjë zgjidhjeje tjetër, trajtim jo më pak i favorshëm se sa trajtimi që u jepet investitorëve të saj ose investitorëve të një shteti të tretë, cilito që është më i favorshëm për investitorin.

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, secila Palë Kontraktuese duhet t'i ofrojë një investitorin të Palës tjetër Kontraktuese, i cili, në ndonjë nga situatat e referuara në këtë paragraf, pëson një humbje në territorin e saj, që rrjedhin nga:

a) Rekuizimi i investimit ose një pjese të tij nga forcat ose autoritetet e saj; apo

b) Shkatërrimi i investimit ose një pjese të tij nga forcat ose autoritetet e saj, gjë që nuk ka qenë e nevojshme duke marrë parasysh situatën.

Kthimi ose kompensimi që në secilin rast duhet të jetë i menjëhershëm, i përshtatshëm dhe efektiv, dhe sa i përket kompensimit, duhet të jetë në përputhje me nenin 5 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Transferimi i lirë

1. Secila Palë Kontraktuese do të garantojë që të gjitha pagesat në lidhje me investimet në territorin e saj, nga investitorët e Palës tjetër Kontraktuese mund të transferohen brenda dhe jashtë territorit të saj, pa kufizime apo vonesa në një monedhë lehtësisht të konvertueshme. Transferime të tilla përfshijnë:

a) kapitalin fillestar dhe shumat shtesë për të mbajtur ose rritur investimin;

b) të ardhurat;

c) shumat që lidhen me huadhënien apo detyrimet e tjera kontraktuale të ndërmarra për investimin;

d) shumat e caktuara për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me menaxhimin e investimit;

e) honorarët dhe pagesat e tjera që rrjedhin nga të drejtat e referuara në nenin 1, paragrafi 1, shkronjat “c”, “d” dhe “e” të kësaj Marrëveshjeje;

f) fitimet dhe pagesat e tjera të personelit që është i angazhuar nga jashtë në lidhje me investimin;

g) të ardhurat nga shitja e pjesshme ose e plotë apo likuidimi i investimit, duke përfshirë edhe vlerat e mundshme të rritjes;

h) pagesat që lindin nga zgjidhja e një mosmarrëveshjeje.

2. Përveç nëse është rënë dakord ndryshe me investitorin, secila Palë Kontraktuese garanton që investitori mund të kryejë transferime të tilla me kursin e këmbimit të zbatueshëm në datën e



transferimit në pajtim me rregulloret e këmbimit në fuqi të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës është kryer investimi.

Neni 8 Subrogimi

Nëse njëra Palë Kontraktuese ose agjencia e caktuar prej saj (Pala e parë Kontraktuese) kryen pagesën nën një garanci ose kontratë sigurimi në lidhje me një investim në territorin e Palës tjetër Kontraktuese (Pala e dytë Kontraktuese), Pala e dytë Kontraktuese pranon:

a) caktimin për Palën e parë Kontraktuese nëpërmjet ligjit ose me akt ligjor të të gjitha të drejtave dhe pretendimeve të palës së dëmshpërblyer; dhe

b) se Pala e parë Kontraktuese ka të drejtë të ushtrojë të drejtat e tilla dhe të zbatojë kërkesat e tilla në përputhje me subrogimin, në të njëjtën masë si pala e dëmshpërblyer.

Neni 9 Interesat themelore të sigurisë

Kjo Marrëveshje nuk përjashton zbatimin nga secila Palë Kontraktuese të masave të nevojshme për ruajtjen e rendit publik, përmbushjen e detyrimeve të saj në lidhje me ruajtjen ose rivendosjen e paqes ose sigurisë ndërkombëtare, ose mbrojtjen e interesave të saj themelore të sigurisë.

Neni 10 Kushtet më të favorshme

Nëse dispozitat në legjislacionin e një Pale Kontraktuese dhe praktika gjyqësore ose administrative e saj, zotimet specifike për sa i përket një investimi ose detyrimet ndërkombëtare ndërmjet Palëve Kontraktuese përmbajnë një rregull, qoftë të përgjithshëm apo specifik, i cili u jep të drejtën investimeve nga investitorët e Palës tjetër Kontraktuese për trajtim më të favorshëm se sa trajtimi i parashikuar nga kjo Marrëveshje, një rregull i tillë do të ketë përparësi ndaj kësaj Marrëveshjeje deri në atë masë që është më e favorshme.

Neni 11

Mosmarrëveshjet ndërmjet një Pale Kontraktuese dhe një investitori të Palës tjetër Kontraktuese

1. Pa rënë ndesh me nenin 12 (mosmarrëveshjet ndërmjet Palëve Kontraktuese), mosmarrëveshjet ndërmjet një investitori të një Pale Kontraktuese dhe Palës tjetër Kontraktuese në lidhje me një investim nga Pala e parë Kontraktuese të kryer në territorin e Palës së dytë Kontraktuese, të cilat bazohen në një shkelje të pretenduar të detyrimeve nën këtë Marrëveshje, deri në masën e mundshme, do të zgjidhen miqësisht nëpërmjet konsultimeve përmes kërkesës me shkrim nga njëra prej palëve të mosmarrëveshjes (palët e mosmarrëveshjes).

2. Nëse këto konsultime nuk rezultojnë në një zgjidhje brenda gjashtë muajve nga data e kërkesës me shkrim për konsultime, investitori mund të paraqesë mosmarrëveshjen qoftë në gjykata ose tribunale administrative të Palës Kontraktuese në fjalë ose në arbitrazhin ndërkombëtar. Në rastin e fundit, investitori mund të zgjedhë cilindo nga sa më poshtë:

a) Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve (ICSID), e parashikuar në Konventën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të investimeve ndërmjet shteteve dhe shtetasve të shteteve tjera (Konventa ICSID), e hapur për nënshkrim në Uashington, më 18 mars 1965;

b) Rregullat lehtësuese shtesë të ICSID-së, nëse njëra nga Palët Kontraktuese nuk është anëtare e Konventës ICSID, por jo të dyja; ose

c) një tribunal i posaçëm arbitrazhi i cili, përveç nëse nuk është rënë dakord ndryshe nga palët në mosmarrëveshje, themelohet sipas rregullave të arbitrazhit të Komisionit të Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtën Ndërkombëtare të Tregtisë (UNCITRAL).

3. Secila Palë Kontraktuese nëpërmjet kësaj jep miratimin e saj të përvokueshëm dhe të pakushtëzuar për paraqitjen e një mosmarrëveshjeje të investimit në arbitrazhin ndërkombëtar, në përputhje me paragrafin 2.

4. Pasi investitori të ketë referuar mosmarrëveshjen e investimit në arbitrazhin ndërkombëtar, siç është parashikuar në paragrafin 2, zgjedhja e juridiksionit do të jetë përfundimtare.



5. Asnjëra nga Palët Kontraktuese nuk ka të drejtë të ushtrojë mbrojtje diplomatike ose të bëjë kërkesë ndërkombëtare në lidhje me një mosmarrëveshje të investimit të paraqitur në arbitrazhin ndërkombëtar nga investitori i saj në përputhje me paragrafin 2, përveç nëse Pala tjetër Kontraktuese nuk pajtohet me vendimin e arbitrazhit.

6. Procedurat e arbitrazhit në bazë të këtij neni do të zhvillohen me kërkesën e një pale në mosmarrëveshje në vendin që është palë në Konventën e Kombeve të Bashkuara për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Jashtme të Arbitrazhit, të lidhur në Nju-Jork, më 10 qershor 1958.

7. Pala Kontraktuese e interesuar nuk duhet asnjëherë gjatë procesit të përdorë si mbrojtje imunitetin e saj ose faktin se investitori ka pranuar, në bazë të sigurimit, një kompensim që mbulon, plotësisht ose pjesërisht, humbjen ose dëmin e shkaktuar.

8. Tribunali i arbitrazhit, i themeluar në pajtim me paragrafin 2, vendos për çështjet e mosmarrëveshjes në përputhje me këtë Marrëveshje dhe me rregullat e tjera në fuqi të së drejtës ndërkombëtare.

9. Vendimi është detyrues dhe nuk i nënshtrohet ndonjë ankese ose përmirësimi tjetër përveç atyre të parashikuar në Konventën ICSID ose rregullat e arbitrazhit, në të cilat bazohen procedurat e arbitrazhit të zgjedhura nga investitori. Vendimi zbatohet pa vonesë nga Palët Kontraktuese si një vendim i formës së prerë dhe përfundimtar, sipas ligjit të brendshëm.

Neni 12

Mosmarrëveshjet ndërmjet Palëve Kontraktuese

1. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve Kontraktuese për sa i përket interpretimit apo zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, në masën që është e mundur, zgjidhet përmes konsultimeve të drejtpërdrejta. Nëse Palët Kontraktuese bien dakord mbi çështjen konfliktuale, mund të arrihet një marrëveshje me shkrim në lidhje me interpretimin ose zbatimin e ndonjë dispozite të kësaj Marrëveshjeje, e cila është detyruese për çdo tribunal të arbitrazhit të themeluar në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

2. Nëse Palët Kontraktuese nuk mund të arrijnë një marrëveshje brenda gjashtë muajve pas kërkesës për konsultime, mosmarrëveshja, me kërkesën e cilësdo Palë, paraqitet në arbitrazh.

3. Secila nga Palët Kontraktuese emëron një arbitër dhe këta arbitra emërojnë kryetarin, i cili duhet të jetë nga një shtet i tretë. Nëse njëra nga Palët Kontraktuese nuk e ka emëruar arbitrin e vet dhe nuk ka ndjekur ftesën e Palës tjetër Kontraktuese për të bërë atë takim brenda dy muajve nga kërkesa për arbitrazh, arbitri emërohet me kërkesën e asaj Pale Kontraktuese nga Sekretari Përgjithshëm i ICSID-së. Nëse të dy arbitrat nuk mund të bien dakord për zgjedhjen e kryetarit brenda dy muajve nga emërimi i tyre, ky i fundit emërohet me kërkesën e cilësdo Palë Kontraktuese nga Sekretari i Përgjithshëm i ICSID-së.

4. Nëse Sekretari i Përgjithshëm i ICSID-së pengohet në kryerjen e funksioneve të mësipërme ose është shtetas i njëres nga Palët Kontraktuese, Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë vepron si autoritet emëruar. Në rast se Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë pengohet në kryerjen e funksioneve të mësipërme ose është shtetas i njëres prej Palëve Kontraktuese, emërimet bëhen nga ana e nënkryetarit dhe në qoftë se ky i fundit pengohet ose është shtetas i njëres nga Palët Kontraktuese, emërimet bëhen nga një tjetër anëtar i lartë i Gjykatës, i cili nuk është shtetas i njëres nga Palët Kontraktuese.

5. Duke iu nënshtuar dispozitave tjera të hartuara nga Palët Kontraktuese, tribunali cakton procedurën e vet. Tribunali vendos për çështjet e mosmarrëveshjes në përputhje me këtë Marrëveshje dhe rregullat e tjera në fuqi të së drejtës ndërkombëtare. Vendimi i tribunalit është përfundimtar dhe detyrues për çdo Palë Kontraktuese.

6. Secila nga Palët Kontraktuese mbulon koston e anëtarit të vet të tribunalit dhe të përfaqësimit të saj në procedurat e arbitrazhit. Kostoja e kryetarit dhe kostot e mbetura ndahen në pjesë të barabarta nga Palët Kontraktuese, përveç nëse tribunali i arbitrazhit vendos ndryshe.



Neni 13

Konsultimet dhe Shkëmbimi i informacionit

Me kërkesë të secilës Palë Kontraktuese, Pala tjetër Kontraktuese do të bjerë dakord menjëherë me konsultime, për interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Me kërkesë të secilës Palë Kontraktuese, informacioni do të shkëmbehet për ndikimin që ligjet, rregulloret, vendimet, praktikatat ose procedurat administrative, ose politikat e Palës tjetër kontraktuese do të mund të kenë në investimet e mbuluara nga kjo Marrëveshjeje.

Neni 14

Mohimi i përfitimeve

1. Pala Kontraktuese mund të mohojë përfitimet e kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë të drejtën për të filluar ose vazhduar procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, për një investitor të Palës tjetër Kontraktuese dhe investimet e atij investitori, nëse:

a) investitori është në pronësi ose kontrollohet nga personat që kanë shtetësinë e një shteti që nuk është Palë Kontraktuese ose Palë mohuese; ose

b) investitori nuk kryen aktivitete biznesi thelbësore në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 15

Dispozita të tjera

Secila Palë Kontraktuese, në përputhje me ligjet, rregulloret dhe praktikatat e saj administrative të ndjekura, shqyrton në mirëbesim kërkesat për hyrjen dhe qëndrimin e investitorëve, punonjësve dhe punëtorëve të Palës tjetër, që janë përfshirë në aktivitete të lidhura me investime.

Neni 16

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e pranimit të njoftimit të dytë, që konfirmon se të dyja Palët Kontraktuese kanë respektuar kërkesat ligjore për hyrjen në fuqi të marrëveshjeve ndërkombëtare.

2. Kjo Marrëveshje mbetet e detyrueshme për një periudhë prej dhjetë vitesh. Përveç nëse jepet njoftimi me shkrim për përfundimin e saj brenda gjashtë muaj para skadimit të kësaj periudhe, Faqe|5236

Marrëveshja konsiderohet e rinovuar me të njëjtat kushte për një periudhë prej dy vitesh e kështu me radhë.

3. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin me shkrim të të dyja Palëve Kontraktuese. Ndryshimet hyjnë në fuqi në pajtim me të njëjtën procedurë ligjore të kërkuar për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

4. Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje përmes njoftimit me shkrim, dispozitat e neneve 1 deri 16 vazhdojnë të jenë në fuqi për një periudhë prej dhjetë vitesh, përveç nëse në mënyrë specifike është rënë dakord ndonjë afat më i gjatë, për investimet e bëra para datës efektive të ndërprerjes.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, të autorizuar në mënyrë të rregullt nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në dy kopje, në Tiranë, më 3 maj 2016, në gjuhët shqipe, serbe dhe angleze, ku secili tekst është njëloj autentik. Në rast se ka dallime në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

VENDIM

Nr. 381, datë 25.5.2016

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. KRISTO TILE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 147/2015, “për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Kristo Tile, në masën 6 200 000 (gjashtë milionë e dyqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale përkatëse të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

**URDHËR****Nr. 64, datë 23.5.2016****PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000/2003, “Për organizmin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, nenit 27, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, shkresës nr. 4630, datë 4.4.2016, “Për caktimin e nëpunësit autorizues të Ministrisë së Financave”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Ministrinë e Financave, në cilësinë e nëpunësit autorizues, znj. Ilda Malile.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga nëpunësi autorizues, me hyrjen në fuqi të këtij urdhri, për një periudhë deri më 31.12.2016.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet nëpunësi autorizues, znj. Ilda Malile.

4. Urdhri nr. 7, datë 13.1.2016, i ministrit të Financave, “Për delegim kompetencash”, shfuqizohet.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE**Arben Ahmetaj****VENDIM****Nr. 26, datë 19.5.2016****NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 24.3.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh çështjen me nr. 74/28 Akti, që u përket:

KËRKUES: Arben Biçaku**SUBJEKT I INTERESUAR:** Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 00-2015-1293, datë 11.6.2015 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr. 850, datë 18.12.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 247, datë 10.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

BAZA LIGJORE: Nenet 30, 31/d, 32/2, 37, 42, 43 dhe 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuësit, që kërkoj pranimin e kërkesës, pretendimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që kërkoj, gjithashtu, pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:**I**

1. Nga materialet e çështjes në shqyrtim rezulton se ndaj kërkuësit Arben Biçaku dhe shtetasit E.B. ka filluar procedimi penal për kryerjen e veprës penale të shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese, e parashikuar nga neni 114/a, pikat 2 dhe 6 dhe neni 25 të Kodit Penal, sipas rregullimeve të vitit 2000 kur është kryer vepra penale. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë me vendimin e datës 7.7.2000, ka vendosur pushimin e hetimeve për kërkuësin, ndërsa me vendimin e datës 24.11.2000 ka vendosur dërgimin e çështjes në gjykatë për shtetasin E.B.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 34, datë 7.3.2001, ka vendosur deklarimin fajtor të shtetasit E.B. për kryerjen e veprës penale “Favorizim prostitucioni në rrethana rënduese” dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim.

3. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 135, datë 5.6.2001, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 34, datë 7.3.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 95, datë 9.10.2001, ka vendosur



pushimin e gjykimit të çështjes penale nr. 104, datë 23.7.2001 në ngarkim të subjektit të interesuar, shtetasit E.B.

5. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 95, datë 3.5.2002, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 95, datë 9.10.2001 të Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë dhe dërgimin për rigjykim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

6. Ndaj këtij vendimi shtetasi E.B. ka paraqitur rekurs dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 594, datë 25.10.2002, ka vendosur mospranimin e rekursit.

7. Në këto kushte çështja është rikthyer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, e cila, me vendimin nr. 19, datë 27.3.2003, ka vendosur kalimin e akteve të procedimit penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Pas kryerjes së veprimeve procedurale dhe vendimit nr. 192, datë 16.10.2003 të Prokurorit të Përgjithshëm për shfuqizimin e vendimit të datës 7.7.2000 për pushimin e hetimeve, kërkuesit Arben Biçaku i është komunikuar akuza për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga nenet 114/2 dhe 25 të Kodit Penal të kohës kur është kryer vepra penale.

8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 80, datë 20.4.2007, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit Arben Biçaku dhe shtetasit E.B. për kryerjen e veprës penale të shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese dhe dënimin e tyre përkatësisht me 7 vjet burgim kërkuesin dhe 7 vjet e 6 muaj burgim shtetasin E.B.

9. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 139, datë 23.6.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 80, datë 20.4.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

10. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 951, datë 3.11.2010, ka vendosur prishjen e vendimeve nr. 139, datë 23.6.2008 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr. 80, datë 20.4.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, si dhe kthimin e akteve për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë me tjetër trup gjykues.

11. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 247, datë 10.12.2013, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit Arben Biçaku dhe

të shtetasit E.B. për kryerjen e veprës penale të shfrytëzimit të prostitucionit në rrethana rënduese, e kryer në bashkëpunim, dhe dënimin e secilit me nga 7 vjet burgim.

12. Mbi ankimin e kërkuesit dhe të shtetasit E.B., Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 850, datë 18.12.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 247, datë 10.12.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

13. Mbi rekursin e kërkuesit dhe të shtetasit E.B., Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me vendimin nr. 00-2015-1293, datë 11.6.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit.

II

14. **Kërkuesi Arben Biçaku** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë me pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor në disa aspekte, duke argumentuar si vijon:

14.1 *Është cenuar parimi i barazisë së armëve*, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe Gjykata e Apelit Vlorë i kanë bazuar vendimet e tyre vetëm në thëniet e dëshmitarëve dhe kërkuesi nuk ka pasur mundësinë për t'u ballafaquar me këto dëshmi. Ai është deklaruar fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, pasi thëniet e dëshmitareve, të cilat janë shtetase të huaja, janë marrë në kundërshtim me KPP-në. Kontrolli i banesës është bërë pa autorizim dhe pa mbajtur procesverbal nga punonjësit e policisë.

14.2 *Është cenuar e drejta e mbrojtjes*, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë nuk ka respektuar rregullat për ndryshimin e akuzës dhe njoftimin e akuzës së re të pandehurit në mungesë, sipas neneve 372 dhe 376 të KPP-së.

14.3 *Është cenuar parimi i sigurisë juridike*, pasi shfuqizimi i vendimit për pushimin e hetimeve është marrë kryesisht nga Prokurori i Përgjithshëm, 3 vjet pas marrjes së vendimit nga Prokuroria e Rrethit Lushnjë.

14.4 *Është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor*, pasi *procedurat penale kanë zgjatur tej një afati të arsyeshëm*. Hetimi i çështjes penale ka zgjatur më shumë se 4 vjet nga regjistrimi i procedimit penal, ndërsa gjykimi penal ka zgjatur me shumë se 10 vjet duke filluar nga data



3.6.2004 kur është dërguar çështja penale për gjykim deri në datën 18.12.2014 kur vendimi ka marrë formë të prerë.

14.5 Është cenuar e drejta e prezumimit të pafajësisë, pasi gjykatat i kanë bazuar vendimet e tyre vetëm mbi një provë të vetme, siç janë thëniet e dëshmitarëve.

14.6 Është cenuar e drejta për akses dhe standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duke vendosur mospranimin e rekursit nuk ka marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, të cilat lidhen me aspekte të rëndësishme të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

15. **Subjekti i interesuar Prokuroria e Përgjithshme** paraqiti parashtrime me shkrim duke argumentuar se pretendimet e paraqitura nga kërkuarësi lidhen me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor e se kërkesa duhet pranuar. Pretendimet janë të natyrës kushtetuese dhe janë paraqitur edhe në rekursin në Gjykatën e Lartë. Këto pretendime nuk kanë marrë përgjigje nga Gjykata e Lartë, si rrjedhojë është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

16. Kërkuarësi ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është cenuar parimi i barazisë së armëve, e drejta e mbrojtjes, parimi i sigurisë juridike, prezumimi i pafajësisë, e drejta për akses dhe standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor.

17. Gjykata në seancën e datës 1.3.2016 ka vendosur pranimin e kërkesës për heqje dorë nga gjykimi i çështjes të tre prej gjyqtarëve të trupit gjykues.

18. Gjykata, pasi mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, gjatë votimit në lidhje me to nuk arriti shumicën e votave të të gjithë anëtarëve për asnjërin prej tyre¹. Në kushtet kur nuk plotësohen kushtet e nenit 73/3, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” dhe kur asnjë përfundim i çështjes nuk u votua nga shumica e kërkuar nga neni 133/2 i

Kushtetutës dhe neni 72/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, Gjykata, në bazë të nenit 74 të ligjit organik, arrin në përfundimin se kërkesa e kërkuarit duhet të refuzohet. Megjithatë, ajo rithekson se në referim të përcaktimeve të nenit 74, refuzimi nuk përbën pengesë që kërkuarësi ta riparaqesë kërkesën në rast se krijohen kushte për formimin e shumicës së kërkuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “F”, 134/1/g, dhe 133/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 72/2 dhe 74 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Refuzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha

VENDIM

Nr. 27, datë 19.5.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 10.12.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 71/25 Akti, që u përket:

¹ Votuan për pranimin pjesërisht të kërkesës gjyqtarët: Bashkim Dedja, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha. Votoi për pranimin tërësisht të kërkesës gjyqtari Sokol Berberi. Votuan për rrëzimin gjyqtarët: Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj.



KËRKUES: Xhevdet Aliaj

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Sarandë

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuashëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2014-3734 (712), datë 18.12.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 43, 131/f, 134/1/g dhe 135/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me kontratën e shitblerjes nr. 599 rep., nr. 464 kol., datë 31.7.2008, kërkuari Xhevdet Aliaj ka blerë nga Bashkia Sarandë sipërfaqen e truallit prej 165 m², e ndodhur në lagjen nr. 2 në Sarandë. Për regjistrimin e kontratës ai i është drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Sarandë, e cila e ka refuzuar kërkesën. Me urdhrin nr. 652, datë 21.4.2010 edhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP) Tiranë e ka refuzuar kërkesën për regjistrimin e pronës së kërkuarit. Për këtë arsye kërkuari i është drejtuar gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

2. Me vendimin nr. 1222, datë 8.9.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka vendosur: *“Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë të paditësit Xhevdet Aliaj. Shfuqizimin e aktit administrativ, urdhrin nr. 652, datë 21.4.2010 të ZQRPP-së Tiranë. Tiranë. Detyrimin e palës së paditur, ZVRPP-së Sarandë, të regjistrojë në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme kontratën e shitjes të datës 31.7.2008, nr. 599 rep., nr. 464 kol. Pushimin e gjykimit të çështjes për kërkimin: detyrimin e palës së paditur të më pajisë me vërtetim hipotekor për sipërfaqen e truallit prej 400 m² të*

regjistruar në ZVRPP-në Sarandë, në datën 9.2.1998, me nr. 71, nr. 82 indeksi, e ndodhur në lagjen nr. 2, Sarandë.”.

3. Me vendimin nr. 378, datë 9.11.2010, Gjykata e Apelit Gjyrokastër ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1222, datë 8.9.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

4. Me vendimin nr. 00-2014-3734 (712), datë 18.12.2014, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 1222, datë 8.9.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe të vendimit nr. 378, datë 9.11.2010 të Gjykatës së Apelit Gjyrokastër, si dhe rrëzimin e kërkesëpadisë.”.*

II

5. **Kërkuari** Xhevdet Aliaj i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë me pretendimin se i ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime:

5.1 Kolegji Administrativ nuk mund të konstatonte kryesisht dhe të vendoste pa asnjë kërkim nga palët pavlefshmërinë absolute të një kontrate administrative, për rrjedhojë edhe të veprimeve juridike të mëpasshme. Ndryshe nga konstatimi i pavlefshmërisë absolute të një veprimi juridik midis palëve private, çka mund të bëhet kryesisht nga gjykata, në rastin e konstatimit të pavlefshmërisë absolute të një akti administrativ apo një kontrate administrative, kjo mund të bëhet nga gjykata vetëm në bazë të një kërkitimi që paraqitet në formën e duhur ligjore nga pala e legjitimuar, në rastin konkret vetëm nga Bashkia e Sarandës.

5.2 Në rastin konkret refuzimi i regjistrimit të titullit të pronësisë është bërë nga ana e ZVRPP-së me një akt të saj pa u mbështetur në një vendim gjyqësor dhe titulli i pronësisë është goditur nga Kolegji Administrativ pa një proces të rregullt dhe duke cenuar parimin e sigurisë juridike.

5.3 Është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi çdo subjekt, në rastin konkret kërkuari, i cili e ka fituar titullin në bazë të aktit administrativ, kontratës së shitjes të lidhur me Bashkinë e Sarandës, duhet të ketë garancinë që ky titull mund të kundërshtohet vetëm nga pala që legjitimohet dhe vetëm në bazë të procedurës së parashikuar me ligj.



6. **Subjekti i interesuar**, ZQRPP-ja Tiranë, në parashtrimet drejtuar Gjykatës ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke argumentuar sa vijon:

6.1 Gjykata e Lartë ka vepruar drejt duke marrë parasysh të gjitha dispozitat me karakter rregullator mbi vlefshmërinë e veprimeve juridiko-civile të shitjes së sendeve të paluajtshme.

6.2 Tjetërsimi i trualit në rastin konkret është bërë pa pasur shitësi, pra Bashkia e Sarandës, tagrat e pronarit, për rrjedhojë kjo kontratë shitje nuk përbën titull pronësie të detyrueshëm për regjistrim, në kuptim të nenit 24/4 të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

6.3 Në rastin konkret, ZRPP-ja ka zbatuar dhe vlerësuar drejt ligjin në lidhje me arsyetimin e refuzimit të kryerjes së regjistrimit të aktit kontratë shitje për sipërfaqen e kërkuar nga kërkuesi.

7. **Subjekti i interesuar**, ZVRPP-ja Sarandë, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim para Gjykatës lidhur me pretendimet e ngritura në kërkesë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga ligji. Në kuptim të nenit 30, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, individi, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij, mund ta paraqesë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese brenda 2 vjetëve nga data e njoftimit të vendimit të fundit të organit përkatës shtetëror. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se vendimi më i fundit në kohë është vendimi nr. 00-2014-3734 (712), datë 18.12.2014 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione materiae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/2 të Kushtetutës, pasi pretendimet e ngritura në kërkesë për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe të parimit të sigurisë juridike janë të tilla që *prima facie* i përkasin juridiksionit kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj

9. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Administrativ nuk mund të konstatonte kryesisht dhe të vendoste pa asnjë kërkim nga palët pavlefshmërinë absolute të një kontrate administrative, për rrjedhojë edhe të veprimeve juridike të mëpasshme, pasi konstatimi i pavlefshmërisë absolute i një akti administrativ apo një kontrate administrative, mund të bëhet nga gjykata vetëm në bazë të një kërkimi që paraqitet në formën e duhur ligjore nga pala e legjitimuar, në rastin konkret vetëm nga Bashkia e Sarandës.

10. Gjykata ka theksuar se bazuar në parimin *jura novit curia*, ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj dhe nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që u është bërë fakteve të çështjes nga kërkuesi (*shih vendimin nr. 29, datë 15.5.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se pretendimet e mësipërme të kërkuesit duhet të trajtohen në këndvështrim të respektimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj.

11. Shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*” është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Ky element karakterizohet, në kuptimin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjrisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 32, datë 25.5.2015; nr. 40, datë 25.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, të sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, Gjykata ka vlerësuar se kompetenca e saj për shqyrtimin e çështjeve nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e



apelit. Në të drejtën procedurale civile kufijtë brenda të cilëve Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë shqyrton çështjet mbi rekursin e ushtruar janë parashikuar në nenet 472 dhe 485 të KPC-së. Sipas nenit 472 të KPC-së, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, kurse neni 485 i KPC-së i ka dhënë të drejtë Kolegjit Civil apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që, ndër të tjera, të vendosë prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të lërë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe të ndryshojë njëkohësisht vendimet e të dyja gjykatave më të ulëta (*shih vendimin nr. 40, datë 25.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Sipas jurisprudencës kushtetuese procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtësi të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin në fakt (*shih vendimin nr. 83, datë 30.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë vepron në bazë të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Në nenin 58 të ligjit parashikohet se mund të bëhet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë vetëm kur: a) ligji material nuk është respektuar, është interpretuar ose zbatuar keq apo vendimi i dhënë është në kundërshtim me një vendim të

Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ose të kolegjeve të bashkuara të Gjykatës së Lartë; b) ka shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjykimit; c) ka shkelje të rënda procedurale, të cilat kanë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimit. Bazuar në nenin 63 të po këtij ligji, Kolegji Administrativ, pasi shqyrton çështjen në dhomë këshillimi ose në seancë gjyqësore vendos: a) mospranimin e rekursit, në rastet kur është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon neni 58 i këtij ligji; b) prishjen e vendimit të gjykatës administrative të apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë; c) prishjen e vendimit të apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën administrative të apelit me tjetër trup gjykues ç) prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes; d) prishjen e vendimeve të gjykatës administrative të apelit dhe të gjykatës administrative të shkallës së parë, si dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë me tjetër trup gjykues; dh) ndryshimin e vendimeve të shkallës së parë dhe të apelit; e) lënien në fuqi të vendimit të apelit.

15. Nga analiza e vendimeve gjyqësore rezulton se gjykatat e faktit e kanë pranuar padinë e ngritur nga kërkuesi, duke arsyetuar se dokumentacioni i paraqitur prej tij ka qenë i plotë dhe në përputhje me ligjin “Për urbanistikën” dhe se urdhër-refuzimi i Kryeregjistruesit është relativisht i pavlefshëm. Po ashtu, ato kanë vlerësuar se pretendimi që kontrata është lidhur në kundërshtim me ligjin “Për shitblerjen e trojeve” është i pabazuar, kurse pretendimi se prona nuk ka qenë e regjistruar më parë në pronësi të Bashkisë Sarandë nuk mund të përbëjë shkak për refuzimin e regjistrimit dhe nuk ndikon në vlefshmërinë e veprimit juridik. Në ndryshim nga përfundimet e arritura nga gjykatat e faktit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se “[...] kontrata e shitblerjes nr. 599 rep., nr. 464 kol., datë 31.7.2008 [...] është absolutisht e pavlefshme në zbatim të nenit 92/a të Kodit Civil, pasi vjen në kundërshtim me ligjin. Ky Kolegj konstaton se veprimi juridik sa më lartë cituar vjen në kundërshtim dhe me ligjin nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve” [...]. Në të tilla rrethana, nëse paditësi do të provonte pronësinë mbi objektin, nuk mund të bëjë tjetërsimi i tij pa u kompensuar më parë ish-pronarët fizikë”.



16. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ka konstatuar kryesisht dhe jashtë kërkimeve të palëve pavlefshmërinë e kontratës së shitblerjes të datës 31.7.2008 të lidhur ndërmjet kërkuesit dhe Bashkisë së Sarandës dhe, gjithashtu, ka konkluduar apriori nëse është vërtetuar ose jo një fakt i caktuar, pra nëse kërkuesi ndodhet apo jo përpara rasteve përjashtimore që parashikon ligji, ndërkohë që përmbajtja e vendimeve të gjykatave të faktit tregon se ky fakt nuk u është nënshtruar vlerësimeve të këtyre gjykatave. Nëse Gjykata e Lartë do të kishte dyshime në lidhje me vlefshmërinë e kontratës, ajo duhej ta kthente çështjen për rigjykim, në përputhje me kompetencat e saj të parashikuara në ligjin e posaçëm për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ajo në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel, duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Gjykata e Apelit Gjirokastrë. Një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj të zhvilluar nga Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj.

17. Bazuar në standardet e mësipërme dhe rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata vlerëson se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vepruar tej kompetencave të tij ligjore, duke cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, si një nga elementet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

18. Kërkuesi ka pretenduar se është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi çdo subjekt që e ka fituar titullin në bazë të aktit administrativ, në rastin konkret në bazë të kontratës së shitjes të lidhur me Bashkinë e Sarandës, duhet të ketë garancinë që ky titull mund të kundërshtohet vetëm nga pala që legjitimohet dhe vetëm në bazë të procedurës së parashikuar me ligj. Sipas tij, refuzimi i regjistrimit të titullit të pronësisë është bërë nga ana e ZVRPP-së me një akt të saj, pa u mbështetur në një vendim gjyqësor, si dhe titulli i pronësisë është goditur nga Kolegji Administrativ pa një proces të rregullt, në cenim të parimit të sigurisë juridike.

19. Duke e vlerësuar pretendimin e kërkuesit në këndvështrim të respektimit të standardeve të

mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se ai nuk ka mundur ta ngrejë atë në nivel kushtetues, duke mos arritur të argumentojë se në ç'mënyrë gjykatat kanë cenuar parimin e sigurisë juridike. Vetëm fakti i fitimit të pronësisë me anë të një akti administrativ apo shqyrtimi i vlefshmërisë së këtij akti nuk përbën argument të mjaftueshëm kushtetues për të mbështetur kërkesën. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72, 77 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2014-3734 (712), datë 18.12.20014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Gani Dizdari

Anëtare kundër: Altina Xhoxhaj

MENDIM PARALEL

1. Në çështjen me kërkues shtetasin Xhevdet Aliaj Gjykata ka vendosur shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2014-3734 (712), datë 18.12.20014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, pasi ky i fundit ka vepruar tej kompetencave të tij ligjore, duke cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj (*shih paragrafin nr. 17 të vendimit*). Edhe pse në qëndrimin përfundimtar pajtohem me vendimin e shumicës, cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor e shoh nën një aspekt më të gjerë.



2. Për sa i përket parimit të gjykatës së caktuar me ligj, ai është trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e Gjykatës. Lidhur me vlerësimin e provave nga Gjykata e Lartë, sikurse thekson edhe shumica në vendimin e saj (*shih paragrafin nr. 13 të vendimit*), kjo e fundit jo vetëm nuk ka kompetencën të administrojë prova të reja, por, gjithashtu, nuk mund të vlerësojë ndryshe provat e vlerësuara nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të anashkalojë ekzistencën e fakteve dhe të rrethanave që janë vërtetuar në gjykimin e faktit apo t'i ndryshojë ato (*shih vendimet nr. 53, datë 20.7.2015; nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Konkretisht, sipas jurisprudencës kushtetuese, parimi i gjykatës së caktuar me ligj konsiderohet i cenuar, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata është shprehur se në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtësi të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin në fakt (*shih vendimin nr. 32, datë 25.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë nuk mund të konkludojë *a priori* nëse është vërtetuar apo jo një fakt i caktuar. Në rast se Gjykata e Lartë vlerëson se provat e administruara nuk janë të mjaftueshme për arritjen e një konkluzioni apo se nevojitet kryerja e vlerësimeve të mëtejshme të tyre, ajo nuk mund të marrë kompetencat e gjykatës të faktit, pasi një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj, por duhet ta kthejë çështjen për

rishqyrtim, me qëllim plotësimin e këtyre të metave të vendimit. Nëse Kolegji Administrativ ka arritur në një përfundim të ndryshëm nga gjykatat e faktit, atëherë ai duhet t'i prishë të dyja vendimet gjyqësore dhe ta kthejë çështjen për rigjykim (*shih vendimin nr. 32, datë 25.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në rastin në shqyrtim jam dakord me përfundimin e shumicës së Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka konstatuar kryesisht dhe jashtë kërkimeve të palëve pavlefshmërinë e kontratës së shitblerjes të datës 31.7.2008, të lidhur ndërmjet kërkuesit dhe Bashkisë së Sarandës dhe, gjithashtu, ka konkluduar *apriori* nëse është vërtetuar ose jo një fakt i caktuar, pra nëse kërkuesi ndodhet apo jo përpara rasteve përjashtimore që parashikon ligji, ndërkohë që përmbajtja e vendimeve të gjykatave të faktit tregon se ky fakt nuk u është nënshtruar vlerësimeve të këtyre gjykatave (*shih paragrafin nr. 16 të vendimit*). Rrjedhimisht pajtohem me vendimin e shumicës së për këtë arsye është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj në procesin e zhvilluar në Gjykatë të Lartë.

6. Gjithsesi, në ndryshim nga shumica, mendoj se ky parim është cenuar edhe në një këndvështrim tjetër. Në rastin në fjalë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 1222, datë 8.9.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe të vendimit nr. 378, datë 9.11.2010, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, si dhe rrëzimin e kërkesëpadisë”.

7. Sikurse thekson edhe shumica (*shih paragrafin nr. 14 të vendimit*), kompetencat e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë janë të parashikuara në nenin 63 të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”². Duke ritheksuar

² Kolegji Administrativ, pasi shqyrton çështjen në dhomë këshillimi ose në seancë gjyqësore vendos:

a) mospranimin e rekursit, në rastet kur është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon neni 58 i këtij ligji;

b) prishjen e vendimit të gjykatës administrative të apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë;

c) prishjen e vendimit të apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën administrative të apelit me tjetër trup gjykues;



qëndrimin tim të shprehur tashmë (*shih mendimin paralel të vendimit nr. 83, datë 30.12.2015*), Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk mund të prishë vendimet e gjykatave të faktit dhe të shprehet mbi themelin e çështjes, siç ka vepruar edhe në çështjen në fjalë, pasi në të gjitha rastet e parashikuara nga neni 63 i lartpërmendur, prishja e vendimit të gjykatave të faktit lidhet me rikthimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë (shih nenin 63, shkronjat “b”, “c” dhe “d”). Ky qëndrim i ligjvënësit mendoj se është në të njëjtën linjë edhe me rolin e Gjykatës së Lartë si gjykatë ligji. Në të kundërt, nëse Gjykata e Lartë do ta prishte vendimin dhe do të shqyrtonte themelin e çështjes, ajo nuk do të mund t'i shmangej vlerësimit të provave, gjë që do ta kthente atë në gjykatë fakti të shkallës së tretë, duke kompromentuar në këtë mënyrë rolin dhe misionin e saj.

8. Në rastin konkret, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë edhe pse në dispozitiv ka përdorur fjalën “ndryshim vendimi”, duke ju referuar shkronjës “dh” të nenit 63, *de facto* ai i ka prishur vendimet e gjykatave të faktit dhe ka rrëzuar kërkesëpadinë e kërkuarit, duke shqyrtuar në këtë mënyrë themelin e çështjes, në tejkalim të kompetencave të sanksionuara në nenin 141 të Kushtetutës, në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë. Kompetencën që ligjvënësi i ka njohur Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për të ndryshuar vendimet e shkallës së parë dhe të apelit, ai e ka interpretuar në mënyrë të zgjeruar, si nga pikëpamja literale, ashtu edhe kushtetuese, duke e shndërruar veten nga gjykatë ligji në gjykatë fakti. “Ndryshimi”, në kuptim të shkronjës “dh” të nenit 63, lidhet me ndreqjen, plotësimin ose korrigjimin e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë apo të apelit, pa shqyrtuar në asnjë rast themelin e tyre (rrëzimin apo pranimin e padisë). Prandaj mendoj se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj edhe në këtë aspekt.

-
- c) prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes;
d) prishjen e vendimeve të gjykatës administrative të apelit dhe të gjykatës administrative të shkallës së parë, si dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë me tjetër trup gjykues;
dh) ndryshimin e vendimeve të shkallës së parë dhe të apelit;
e) lënien në fuqi të vendimit të apelit.

9. Përveç sa më lart, jam i mendimit se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke gjykuar çështjen në themel në dhomë këshillimi, pa pjesëmarrjen e kërkuarit, nuk ka respektuar edhe të drejtën e tij për t'u dëgjuar, si dhe parimin e kontradiktoritetit. Në këto raste (shqyrtimi i çështjes në themel në dhomë këshillimi) vlerësoj se Gjykata e Lartë duhet të marrë të gjitha masat për respektimin e standardeve themelore kushtetuese të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke lajmëruar palët për datën e seancës, në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë të marrin pjesë në proces dhe të dëgjohen, qoftë edhe mbi bazën e dokumenteve (të paraqesin parashtrimet /prapësimet e tyre).

10. Si përfundim, mendoj se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë i ka cenuar kërkuarit të drejtën për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosrespektimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, të së drejtës për t'u dëgjuar, si dhe të parimit të kontradiktoritetit.

Anëtar: Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin mendim me shumicën për pranimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuari Xhevdet Aliaj dhe, për rrjedhojë, shfuqizimin e vendimit nr. 00-2014-3734 (712), datë 18.12.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, vlerësoj të paraqes, shkurtimisht, argumentet për qëndrimin tim në pakicë.

2. Në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës, kërkuari ka pretenduar se Kolegji Administrativ nuk mund të konstatonte kryesisht dhe të vendoste pa asnjë kërkim nga palët pavlefshmërinë absolute të një kontrate administrative, për rrjedhojë edhe të veprimeve juridike të mëpasshme; refuzimi i regjistrimit të titullit të pronësisë është bërë nga ana e ZVRPP-së me një akt të saj pa u mbështetur në një vendim gjyqësor dhe titulli i pronësisë është goditur nga Kolegji Administrativ pa një proces të rregullt; është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi çdo subjekt, në rastin konkret kërkuari, i cili e ka fituar titullin në bazë të aktit administrativ, kontratës së shitjes të lidhur me Bashkinë e Sarandës, duhet të ketë garancinë që ky titull mund të kundërshtohet vetëm nga pala që



legjitimohet dhe vetëm në bazë të procedurës së parashikuar me ligj.

3. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike bashkohem me qëndrimin e shumicës se kërkuksi nuk ka mundur ta ngrejë atë në nivel kushtetues, duke mos arritur të argumentojë se në ç'mënyrë gjykatat e kanë cenuar këtë parim (*paragrafi 19 i vendimit*). Por në ndryshim nga qëndrimi i shumicës, vlerësoj se kërkuksi nuk duhej të legjitimohej *ratione materia* edhe për pretendimin për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj. Sipas shumicës, bazuar në parimin *jura novit curia*, pretendimet e kërkuksit se Kolegji Administrativ nuk mund të konstatonte kryesisht dhe të vendoste pa asnjë kërkim nga palët pavlefshme-rinë absolute të një kontrate administrative, për rrjedhojë edhe të veprimeve juridike të mëpasshme, duhet të trajtohen në këndvështrim të respektimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj. Parimi *jura novit curia* kërkon që pretendimet e paraqitura nga kërkuksi të jenë ngritur në nivel kushtetues, por në të tilla raste Gjykata vetëm vlerëson nëse ato bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, të ndryshme nga ajo e referuar nga kërkuksi. Në këtë kuptim, Gjykata nuk mundet që pretendime ligjore të paraqitura në kërkesë t'i ngrejë kryesisht në nivel kushtetues, siç ka ndodhur në rastin konkret. Gjykata ka theksuar se procesi i gjykimit kushtetues është i natyrës argumentuese, që nënkupton se u takon palëve, kërkuksit dhe subjektit të interesuar, të parashtrojnë argumentet faktike dhe ligjore mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre. Është detyrë e palëve të shpjegojnë arsyet të cilat kanë çuar, sipas këndvështrimit të tyre, në shkelje të Kushtetutës dhe më konkretisht të procesit të rregullt ligjor. Sipas nenit 28 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", kërkesa duhet të përmbajë, *inter alia*, objektin e kërkesës (*pika "ç"*), parashtrimin e shkaqeve (*pika "d"*), si dhe treguesin e dokumenteve dhe mjeteve të tjera provuese që shoqërojnë kërkesën (*pika "dh"*). Në rastin konkret kërkuksi nuk ka arritur të paraqesë pretendimet kushtetuese mbi bazën e të cilave mund të vihet në lëvizje gjykimi kushtetues për shkelje të nenit 42 të Kushtetutës.

4. Gjykata vazhdimisht ka theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues dhe se kontrolli që ajo ushtron është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Për sa u takon problemeve të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete, ato nuk përbëjnë juridiksion kushtetues nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Edhe në këtë kuptim, pretendimet e ngritura nga kërkuksi kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të ligjit dhe ato nuk bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

5. Për argumentet e parashtruara më sipër vlerësoj se kërkuksi nuk legjitimohet *ratione materia* për t'iu drejtuar Gjykatës, për rrjedhojë kërkesa duhej të rrëzohej.

Anëtare: Altina Xhoxhaj

VENDIM

Nr. 28, datë 19.5.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Sokol Berberi	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Fatmir Hoxha	anëtar i	"	"

me sekretare Edmira Babaj, në datën 26.1.2016 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 72/26 Akti, që u përket palëve:

KËRKUESE: Nexhmije Salu

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Avokatura e Shtetit, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Zyra e Përmbartimit "Best 2010"

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit nr. 1178, datë



18.9.2014, të Gjykatës Administrative të Rrethit Gjyqësor Durrës, brenda një afati të arsyeshëm.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 5, 17/2, 41, 42/1, 44, 116, 118/1, 131/f, 134/1/g dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); neni 1 i protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; Protokollit nr. 12 i KEDNJ-së; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuases, pretendimet e subjektit të interesuar, Zyrës së Përmbartimit “Best 2010”, që kërkon pranimin e kërkesës dhe pretendimet e subjekteve të interesuara, Avokaturës së Shtetit dhe Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, që kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Nga materialet bashkëlidhur kërkesës rezulton se Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Kavajë, me vendimin nr. 50, datë 1.11.1994, i ka njohur trashëgimlënësit A.D. të drejtën e pronësisë mbi një sipërfaqe prej 1665 m² truall, i ndodhur në fshatin Qerret, Kavajë. Në kushtet kur kjo pronë ka rezultuar e zënë, i është njohur e drejta e kompensimit në natyrë.

2. Trashëgimtarët e ish-pronarit A.D. i janë drejtuar Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) Tiranë për zbatimin e vendimit nr. 50, datë 1.11.1994 të KKKP-së Kavajë.

3. Me shkresën nr. 913/1 prot., datë 9.5.2014 AKKP-ja i ka kthyer përgjigje se me miratimin dhe botimin në fletoren zyrtare të vendimit të Këshillit të Ministrave për kompensimin fizik, përfaqësuesi me prokurë i subjektit të shpronësuar mund të aplikojë pranë këtij institucioni për të përfituar nga fondi përkatës i kompensimit.

4. Kërkesja Nexhmije Salu, si trashëgimtare e radhës së parë e trashëgimlënësit A.D., i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës me padi me objekt detyrimin e AKKP-së të nxjerrë aktin përkatës administrativ për realizimin e së drejtës së kompensimit për sipërfaqen prej 1685 m², me sipërfaqe ekuivalente në zonën turistike në

fshatin Qerret, komuna Golem, rrethi Kavajë, qarku Tiranë, sipas dispozitivit të vendimit nr. 50, datë 1.11.1994 të ish-KKKP-së Kavajë.

5. Me vendimin nr. 1178, datë 18.9.2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka vendosur: “Pranimin e kërkesëpadisë të paditëses Nexhmije Salu. Detyrimin e të paditurit, AKKP- së Tiranë, të nxjerrë aktin përkatës administrativ për realizimin e së drejtës së kompensimit për sipërfaqen prej 1685 m², me sipërfaqe ekuivalente në zonën turistike, në fshatin Qerret, komuna Golem, rrethi Kavajë, qarku Tiranë, sipas dispozitivit të vendimit nr. 50, datë 1.11.1994 të ish-KKKP-së Kavajë”. Vendimi ka marrë formë të prerë në datën 3.11.2014.

6. Kërkesja i është drejtuar Zyrës së Përmbartimit “Best 2010” për të vijuar me procedurat e ekzekutimit, e cila me shkresën nr. 158/1 prot., datë 2.4.2015 “Lajmërim për ekzekutim vullnetar” i ka kërkuar AKKP-së ekzekutimin vullnetar të detyrimit ndaj kërkuases.

7. Me vendimin nr. 158/2 prot., datë 12.5.2015, Zyra e Përmbartimit “Best 2010” ka vendosur fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke kërkuar përmbushjen e detyrimit ndaj kërkuases, si dhe të pagimin e tarifave të shpenzimeve përmbartimore për të zbatuar tërësisht titullin ekzekutiv. Zyra e Përmbartimit ka sqaruar se detyrimi do të ekzekutohet duke i marrë debitorit nga fondi në dispozicion i tokës dhe duke sekuestruar llogarinë e tij pranë thesarit.

8. AKKP-ja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës me padi me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbartimore. Me vendimin nr. 1056, datë 5.10.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka vendosur rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi AKKP-ja ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Bazuar në shkresën nr. 3/1, datë 4.2.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë rezulton se çështja është në pritje për t’u shqyrtuar.

II

9. **Kërkesja Nexhmije Salu** i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, duke argumentuar si vijon:

9.1 Kërkesja ka kërkuar ekzekutimin e



vendimit nr. 1178, datë 18.9.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Sipas saj AKKP-ja nuk ka vullnet për ekzekutimin e vendimit. Veprime të tilla sjellin zvarritje të procesit të kompensimit fizik, duke mos respektuar masat për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. AKKP-ja në zbatim të ligjit nr. 9235/2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” ka pasur detyrimin ligjor për të trajtuar me vendim kërkesën e saj për kompensim me sipërfaqe ekuivalente në zonë turistike.

9.2 Kërkuesja në kuptim të nenit 13 të KEDNJ-së nuk ka në dispozicion asnjë mjet tjetër efektiv për rivendosjen në vend të së drejtës së kompensimit. AKKP-ja me sjelljen e saj ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

10. **Subjekti i interesuar, Zyra e Përmbarrimit “Best 2010” Tiranë**, ka paraqitur parashtrime me shkrim si vijon:

10.1 AKKP-ja nuk e ka zbatuar ende titullin ekzekutiv, edhe pse është lajmëruar me disa shkresa nga kjo zyrë. Ky institucion nuk ka reaguar ende për zbatimin e titullit ekzekutiv, por është mjaftuar me faktin se kjo çështje ligjore gjendet për shqyrtim pranë Gjykatës Administrative dhe pranë Gjykatës Kushtetuese.

11. **Subjekti i interesuar, AKKP-ja**, paraqiti parashtrime me shkrim, duke argumentuar:

11.1 Kërkuesja nuk legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës, pasi procesi gjyqësor për kundërshtimin e veprimeve përmbarrimore është ende në vijim. Për sa kohë procesi nuk ka përfunduar, nuk mund të pretendohet lidhur me ekzekutimin e vendimit të formës së prerë. Edhe sikur procesi të konsiderohej i përfunduar, afati nga dalja e titullit ekzekutiv në datën 12.5.2015 deri në datën e paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, nuk mund të konsiderohet i paarsyeshëm.

11.2 AKKP-ja e ka kundërshtuar ekzekutimin e vendimit të gjykatës administrative, pasi ai ka pasaktësi të dukshme, si dhe paqartësi në lidhje me sa kërkohet të ekzekutohet. Detyrimi i organit administrativ, AKKP-ja në rastin konkret, për nxjerrjen e një akti është i ekzekutueshëm vetëm në rastet kur nuk është

shprehur për kërkesën e themelit në lidhje me procesin e kthimit apo kompensimit të pronës të subjekteve pretenduese si të shpronësuara, të cilat nuk disponojnë një vendim përfundimtar. Po ashtu, gjykata nuk ka përcaktuar as elementet bazë të të dhënave topografike të zonës, që do të shërbenin për kompensim, duke e bërë vendimin praktikisht të pazbatueshëm.

12. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, paraqiti parashtrime me shkrim, duke argumentuar si vijon:

12.1 Pretendimi i kërkueses për mosekzekutimin e vendimit nga ana e AKKP-së është i pabazuar. AKKP-ja e ushtron veprimtarinë e saj në zbatim të ligjit nr. 9235/2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” të ndryshuar, i cili parashikon edhe rregullimin me akte nënligjore të procedurave, rregullave dhe kritereve që duhen zbatuar për shpërndarjen e fondit të kompensimit fizik. Deri në këto momente mungon kuadri ligjor për mënyrën e funksionimit dhe realizimit të procesit të kompensimit fizik, i cili mbi të gjitha kërkon ekzistencën reale të një fondi kompensimi.

12.2 Pretendimi se AKKP-ja ka në dispozicion prona të lira në fshatin Qerret, komuna Golem të rrethit të Kavajës, që do të shërbejnë për kompensimin e subjekteve të shpronësuara, është i pavërtetë dhe i pambështetur në prova. Çdo pasuri e paluajtshme që do të shërbejë për kompensimin, do t’i kalojë AKKP-së me vendim të Këshillit të Ministrave, ndaj ekzekutimi i menjëhershëm i së drejtës së kompensimit është praktikisht i pamundur.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueses

13. Subjekti i interesuar, AKKP-ja, ka pretenduar se kërkuesja nuk legjitimohet në paraqitjen e kësaj kërkesë pasi çështja për kundërshtimin e veprimeve përmbarrimore është ende në shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë dhe nuk ka një vendim përfundimtar lidhur me të.

14. Gjykata Kushtetuese ka përfshirë brenda juridiksionit të saj edhe kontrollin e respektimit të detyrimit të organeve shtetërore për ekzekutimin, brenda një afati të arsyeshëm, të



vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si një nga elementet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në lidhje me shterimin e mjeteve të ankimit, nga materialet e çështjes nuk rezulton që ekzekutimi i vendimit gjyqësor të jetë pezulluar nga gjykata. Për pasojë, ky vendim është i ekzekutueshëm, pavarësisht se ka një proces gjyqësor për kundërshtimin e veprimeve përmbartimore, i cili nuk ka përfunduar ende.

15. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkesja legjitimohet *ratione personae* për t'iu drejtuar Gjykatës, pasi parashikohet si subjekt nga neni 134/1/g i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe *ratione materiae* për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor lidhur me ekzekutimin brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

16. Kërkesja ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit nr. 1178, datë 18.9.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, me anë të të cilit është vendosur detyrimi i AKKP-së Tiranë për të nxjerrë aktin përkatës administrativ për realizimin e së drejtës së kompensimit për sipërfaqen prej 1685 m², me sipërfaqe ekuivalente në zonën turistike në fshatin Qerret, komuna Golem, rrethi Kavajë, qarku Tiranë, sipas dispozitivit të vendimit nr. 50, datë 1.11.1994 të ish-KKKP-së Kavajë.

17. Gjykata ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Parimet kushtetuese të lidhura me procesin e rregullt ligjor, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, i parashikuar në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një element

thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë dhe çdo organ shtetëror duhet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimin nr. 14, datë 30.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykimi për realizimin e një të drejte përbëhet nga dy faza, të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën. Faza e parë, ose gjykimi në kuptimin e ngushtë, ka të bëjë me njohjen ose deklarimin e së drejtës që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë. Në fazën e dytë, kur nevojitet edhe ndërhyrja, qoftë dhe me masa shtrënguese, për zbatimin e vendimit gjyqësor, realizohet ajo që quhet qëllimi i drejtësisë. Në këtë fazë, e drejta është e sigurt, por kërkohet që ajo të vihet në jetë. Në këtë kuptim gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë, pra vetëm me dhënien e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar, nëse ajo nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit, mbetet pa asnjë vlerë. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individ i ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. (*shih vendimin nr. 21, datë 7.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individ i ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Proces i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e të drejtës (*shih vendimin nr. 14, datë 30.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza



ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces (*shih vendimet nr. 14, datë 30.3.2015; nr. 15, datë 30.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuarit, si dhe të autoriteteve përkatëse (*shih vendimet nr. 14, datë 30.3.2015; nr. 15, datë 30.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Bazuar në sa më sipër, edhe në rastin konkret në shqyrtim, për të arritur në një konkluzion nëse jemi përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, duhet ndalur në vlerësimin e secilit prej këtyre elementeve të sipërcituara.

i) Kompleksiteti i çështjes

23. Gjykata ka pohuar vazhdimisht se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 6, datë 23.2.2016; nr. 15, datë 30.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Çështja konkrete ka për objekt mosekzekutimin e vendimit nr. 1178, datë 18.9.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, me anë të të cilit është vendosur detyrimi i AKKP-së Tiranë për të nxjerrë aktin përkatës administrativ për realizimin e së drejtës së kompensimit të ish-pronarëve.

25. Gjykata vëren se nxjerrja e aktit nga AKKP-ja nuk është një veprim formal, por ka si qëllim realizimin faktik të kompensimit fizik, duke përcaktuar vendndodhjen e saktë të pronës që do të jepet për efekt kompensimi. Ky proces përfshin veprimtarinë e disa organeve shtetërore që do të evidentojnë, vlerësojnë dhe përcaktojnë sipërfaqet e lira për kompensim. Këshilli i Ministrave, në bazë të neneve 12 dhe 28, të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, të ndryshuar, miraton kriteret dhe procedurat për caktimin e pronave,

fond pasurie të paluajtshme, për kompensim fizik, si dhe mënyrën e vendosjes së këtij fondi në dispozicion të AKKP-së, e cila do të përmbushë detyrimin për kompensim sipas vendimit përkatës.

26. Në çështjen në shqyrtim me vendimin nr. 1178, datë 18.9.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur kompensimin e pronës prej 1685 m² në një zonë turistike në fshatin Qerret. Sipas pretendimeve të subjektit të interesuar, AKKP-së, për efekt të ekzekutimit të vendimit gjyqësor mungojnë të dhënat topografike të vendndodhjes ku do të realizohet kompensimi dhe nuk ka prona të lira në fshatin Qerret, Bashkia Kavajë.

27. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se çështja konkrete paraqitet komplekse.

ii) Sjellja e kërkuarës

28. Kohëzgjatja e arsyeshme e procedimit të çështjes është vlerësuar nga Gjykata si thelbësore për të përcaktuar nëse ndodhemi para rastit të tejkalimit të afateve të arsyeshme. Ky element lidhet me mosekzekutimin e vendimeve të formës së prerë për faj të veprimeve apo mosveprimeve të kërkuarit, duke sjellë tejkalimin e një afati të arsyeshëm për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

29. Në rastin konkret rezulton se kërkuarja, në cilësinë e trashëgimtares së ish-pronarit fillimisht i është drejtuar me shkresë AKKP-së për kompensimin në natyrë sipas vendimit të KKKP-së. AKKP-ja e ka sqaruar kërkuarën se me miratimin dhe botimin në fletoren zyrtare të VKM-së për kompensimin fizik, ajo mund të aplikojë pranë këtij institucioni për të përfituar nga fondi i kompensimit. Në këto kushte, kërkuarja i është drejtuar me padë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, e cila, me vendimin nr. 1178, datë 18.9.2014, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë. Ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar ankim dhe në datën 3.11.2014 ka marrë formë të prerë. Pas marrjes formë të prerë të vendimit kërkuarja i është drejtuar Zyrës së Përmbarrimit “Best 2010” për të vijuar procedurat e ekzekutimit dhe në datën 2.4.2015 i është drejtuar AKKP-së për të ekzekutuar vendimin në mënyrë vullnetare.

30. Gjykata konstaton se në çështjen konkrete nuk ndodhemi para një afati të paarsyeshëm të kohëzgjatjes së veprimeve për ekzekutimin e



vendimit të formës së prerë, duke pasur parasysh datën 2.4.2015 në të cilën kanë filluar procedurat e ekzekutimit dhe datën 5.10.2015 kur kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese.

iii) Sjellja e autoriteteve

31. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata ka theksuar se përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëloj (*shih vendimin nr. 20, datë 29.4.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Çështja në shqyrtim ka të bëjë me detyrimin e AKKP-së për të nxjerrë aktin administrativ për realizimin e së drejtës së kompensimit të kërkuarës me sipërfaqe ekuivalente dhe me vendndodhje të përcaktuar nga ana e gjykatës. Bazuar në ligjin të ligjit nr. 9235/2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, të ndryshuar, Këshilli i Ministrave përcakton kriteret dhe fondin për kompensim. Vetëm pas miratimit të këtij vendimi dhe paraqitjes së kërkesës nga subjektet e interesuara, brenda afateve të përcaktuara, AKKP-ja investohet me shqyrtimin e dokumentacionit dhe pas verifikimeve që kryen, merr vendimin përkatës.

33. Gjykata konstaton se AKKP-ja nuk rezulton të ketë refuzuar realizimin e kompensimit fizik ndaj kërkuarës, por ka kërkuar respektimin e procedurës ligjore.

34. Gjykata ka theksuar se shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor ose zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetet joefektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë (*shih vendimet nr. 13, datë 21.3.2012; nr. 43, datë 19.12.2007, të Gjykatës Kushtetuese*). Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 13, datë 21.3.2012; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 43, datë 19.12.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Gjykata vlerëson se sjellja e autoriteteve, përfshirë edhe atë të subjektit të interesuar,

AKKP-së, nuk ka qenë shkak për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

36. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarës Nexhmije Saliu është i pabazuar dhe duhet rrëzuar, pasi nuk ka shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f dhe nenit 134/1/g, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 29, datë 19.5.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar	i	Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 30.3.2016, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 8 Akti, që u përket palëve:



KËRKUESE: Doriana Daraku

SUBJEKT I INTERESUAR: Bashkia e Tiranës

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2015-2989 (304), datë 14.5.2015, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 49–52, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1 dhe 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27–30 dhe 45, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Altina Xhoxhaj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkeses, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 892, datë 2.7.2008 të kryetarit të Bashkisë së Tiranës, kërkesja është emëruar në pozicionin e specialistes në Sektorin e Auditimit pranë Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm. Pas një viti në detyrë ajo është konfirmuar si nëpunëse civile në bazë të akteve ligjore në fuqi për statusin e nëpunësit civil.

2. Me urdhrin nr. 1262, datë 26.10.2011 të kryetarit të Bashkisë së Tiranës, kërkesja është liruar nga detyra, për shkak se është punësuar në kundërshtim me kushtet e përcaktuara për audituesin e brendshëm. Këtë vendim kërkesja e ka kundërshtuar në Komisionin e Shërbimit Civil (KSHC).

3. Me vendimin nr. 247, datë 22.12.2011, KSHC-ja ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës, shfuqizimin e aktit nr. 1262, datë 26.10.2011 të kryetarit të Bashkisë për lirimin e kërkeses nga detyra dhe sistemimin e saj në një pozicion tjetër. Kundër këtij vendim ka paraqitur ankim në gjykatë Bashkia e Tiranës.

4. Me vendimin nr. 74, datë 12.7.2012, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 247, datë 22.12.2011 të KSHC-së.

5. Me vendimin nr. 00-2015-2989 (304), datë 14.5.2015, Kolegji Administrativ i Gjykatës së

Lartë në dhomë këshillimi ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 247, datë 22.12.2011 të KSHC-së dhe të vendimit nr. 74, datë 12.7.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrëzimin e padisë.”.

II

6. **Kërkesja Doriana Daraku** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë sipas objektit dhe paraqet këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

6.1 Kolegji Administrativ nuk ka përcaktuar se çfarë shkeljesh janë bërë nga KSHC-ja dhe Gjykata e Apelit në vendimmarrjen e tyre. Ai nuk ka arsyetuar shkaqet për ndryshimin e këtyre vendimeve, si dhe nuk ka përcaktuar se cilat dispozita të ligjit material ose procedural janë keqzbatuar.

6.2 Kolegji Administrativ ka shkelur nenin 49 të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën e punësimit. Vlerësimi i tij ka qenë i gabuar, pasi marrëdhëniet e punës së kërkeses kanë filluar në datën 2.7.2008 dhe rekrutimi është bërë në bazë të konkursit, siç përcaktohet në ligjin për nëpunësin civil. Po ashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Auditimit nuk ka konstatuar shkelje për emërimin e kërkeses në atë pozicion.

6.3 Vlerësimi që i ka bërë Kolegji Administrativ urdhrin të kryetarit të Bashkisë është i gabuar. Edhe pse në pikat 17–22 të vendimit përmenden të drejtat që ka një nëpunës civil, në pikën 23 të tij kjo e drejtë i mohohet kërkeses. Shkeljet në procedurën e konkurrimit nuk janë bërë për faj të kërkeses, prandaj KSHC-ja ka vendosur që ajo të sistemohet në një pozicion tjetër ku plotëson kriteret e konkurrimit, fakt që nuk është vlerësuar nga Gjykata e Lartë.

6.4 Kolegji Administrativ i ka mohuar kërkeses të drejtën e mbrojtjes, të drejtën e informimit dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor, duke përcaktuar se një nëpunës civil nuk ka të drejtën e mbrojtjes në momentin që ai cenohet në mënyrë të padrejtë dhe i mohohet e drejta e punësimit.

7. **Subjekti i interesuar, Bashkia e Tiranës**, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim para Gjykatës lidhur me pretendimet e ngritura në kërkesë.



III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuës

8. Gjykata vëren se kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar në nenin 30/2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

9. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae* në jurisprudencën kushtetuese është theksuar në mënyrë të vazhdueshme se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Gjykata ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese).

10. Kërkuësja ka pretenduar në kërkesë se Kolegji Administrativ nuk ka përcaktuar se çfarë shkeljesh janë bërë nga KSHC-ja dhe Gjykata e Apelit në vendimmarrjen e tyre, nuk ka arsyetuar shkaqet për ndryshimin e këtyre vendimeve, si dhe nuk ka përcaktuar se cilat dispozita të ligjit material ose procedural janë keqzbatuar. Sipas saj, vlerësimi i Kolegjit ka qenë i gabuar, pasi marrëdhëniet e punës së kërkuësës kanë filluar në

datën 2.7.2008 dhe rekrutimi është bërë në bazë të konkursit, siç përcaktohet në ligjin për nëpunësin civil. Po ashtu, kërkuësja pretendon se Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh faktin se shkeljet në emërim nuk janë bërë për faj të saj, prandaj KSHC-ja ka vendosur që ajo të sistemohej në një pozicion tjetër ku plotëson kriteret e konkurrimit. Duke i vlerësuar këto pretendime në bazë të standardeve të mësipërme, Gjykata çmon se në thelb ato kanë të bëjnë me çështje që lidhen me mënyrën e vlerësimit dhe të interpretimit të ligjit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Në kushtet kur këto pretendime kanë të bëjnë me çështje të natyrës ligjore dhe jo kushtetuese, zgjidhja e tyre nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, por i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme. Për rrjedhojë, kërkuësja nuk legjitimohet *ratione materiae* në lidhje me këto pretendime.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të barazisë së armëve

11. Sipas kërkuësës, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i ka mohuar të drejtën e mbrojtjes, të drejtën e informimit dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

12. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t’u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit. E drejta për t’u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake në raport me palën kundërshtare (shih vendimin nr. 31, datë 26.5.2014, të Gjykatës Kushtetuese).

13. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë



mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Shqyrtimi i çështjes dhe nxjerrja e konkluzioneve nga gjykata vetëm mbi bazën e provave të paraqitura nga një palë, pa dëgjuar pretendimet e komentet e palës tjetër, e bën procesin gjyqësor të cenueshëm. E drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin edhe nocionin se të dyja palët në proces kanë të drejtë të kenë informacion për faktet e argumentet e palës kundërshtare, që nënkupton në parim mundësinë që palët në një seancë civile apo penale të kenë njohuri edhe për komentet mbi provat e nxjerra (*shih vendimin nr. 17, datë 18.7.2005, të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto parime, Gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjikata vëren se me miratimin e ligjit nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i cili është legjislacioni i ri procedural i zbatueshëm në këto lloj gjykimesh, është parashikuar, mes të tjerash, edhe procedura e gjykimit të këtyre çështjeve. Sipas nenit 59 të ligjit nr. 49/2012 pala kundër së cilës është bërë rekurs mund të kundërshtojë pretendimet e ngritura në rekurs brenda 15 ditëve nga komunikimi i rekursit dhe mosparaqitja e kundërrekursit brenda këtij afati sjell humbjen e së drejtës për të paraqitur

pretendimet në një fazë të mëvonshme në Gjykatën e Lartë. Dërgimi i dosjes së gjykimit në Gjykatën e Lartë bëhet brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të komunikimeve të rekursit e kundërrekursit palëve ndërgjyqëse në proces (neni 60). Për sa i përket shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, neni 61 i ligjit parashikon se ai bëhet, si rregull, mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi. Për efekt të gjykimit gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve dhe sekretaria e gjykatës njofton me shpallje datën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 21 ditë përpara. Po ashtu, ligji ka parashikuar edhe rastet kur çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore me praninë e palëve (neni 62).

16. Nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për efekte të gjykimit rezulton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me rekursin e subjektit të interesuar, Bashkisë së Tiranës, të datës 27.7.2012. Sipas dëftesës së komunikimit të rekursit të datës 5.12.2012, nuk rezulton që ai t'i jetë njoftuar kërkuases, por është marrë në dorëzim nga një shtetas tjetër (A.K.) dhe nuk ka asnjë shënim për sa i takon lidhjes së tij me kërkuesen. Me vendimin e datës 7.4.2015, gjyqtari relator i çështjes ka vendosur shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi në datën 14.5.2015, duke urdhëruar sekretarinë të bëjë njoftimin e palëve për orën dhe datën e caktuar. Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 14.5.2015 rezulton se Kolegji Administrativ ka vlerësuar se palët kanë marrë dijeni rregullisht sipas ligjit dhe ka marrë në shqyrtim vetëm shkaqet e ngritura në rekurs, ndërkohë që nuk rezulton që kërkuësja të ketë paraqitur kundërrekurs ose parashtrime me shkrim në kundërshtim të pretendimeve të palës tjetër. Përfundimisht, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-2989 (304), datë 14.5.2015, ka vendosur: "*Ndryshimin e vendimit nr. 247, datë 22.12.2011 të KSHC-së dhe të vendimit nr. 74, datë 12.7.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrëzimin e padisë*".

17. Gjikata rithekson dallimin mes shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, sipas nenit 480 të KPC-së, si fazë paraprake ku vlerësohet plotësimi ose jo i kritereve për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, dhe shqyrtimit



të çështjeve në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh sipas ligjit nr. 49/2012. Megjithëse në shqyrtimin e çështjeve administrative Gjykata, përgjithësisht, procedon me shqyrtimin jo në seancë publike me praninë e palëve, por në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumenteve të paraqitura, kjo nuk nënkupton se ky lloj gjykimi përjashton detyrimin për njoftimin e rregullt të palëve në mënyrë që të mbrohen në procesin gjyqësor ku janë palë me anë të paraqitjes së komenteve apo prapësimeve lidhur me pretendimet e palës që ka vënë në lëvizje gjykatën. Qëllimi i ligjvënësit në krijimin e gjykatave administrative ka qenë thjeshtimi i procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, por duke garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshme të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme (*shih vendimin nr. 21, datë 4.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata thekson se Gjykata e Lartë ka detyrimin jo vetëm të njoftojë rregullisht palët për procesin, por edhe t'u sigurojë atyre mundësinë që të marrin pjesë në proces dhe të dëgjohen, qoftë edhe mbi bazën e dokumenteve. Për këtë qëllim Gjykata e Lartë duhet t'u garantojë palëve të drejtën që jo vetëm të njihen në kohë me pretendimet e palës tjetër, por edhe të kenë mundësinë që t'i kundërshtojnë ato apo të paraqesin argumentet e tyre për çështjen.

18. Bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke vendosur vetëm mbi bazën e pretendimeve të subjektit të interesuar të parashtruara në rekurs dhe duke mos i dhënë mundësinë kërkueses që të paraqiste pretendimet e saja në lidhje me çështjen, e ka vendosur atë në një pozitë të pabarabartë në raport me palën tjetër. Duke mos marrë masat për t'i garantuar kërkueses të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur nëpërmjet dhënies së mundësisë së paraqitjes së prapësimeve të saj, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në drejtim të respektimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses është i bazuar dhe kërkesa duhet të pranohet.³

³ Gjyqtari V. Kristo votoi edhe për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, sipas qëndrimit të shprehur në

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72, 77 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

Pranimin e kërkesës.

Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2015-2989 (304), datë 14.5.2015 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

VENDIM

Nr. 30, datë 19.5.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	"	"
Vitore Tusha	anëtare e	"	"
Gani Dizdari	anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	anëtar i	"	"
Fatos Lulo	anëtar i	"	"
Sokol Berberi	anëtar i	"	"

me sekretare Edmira Babaj, në datën 15.3.-2016, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 3 Akti, që u përket:

KËRKUESE: Shoqëria "Schneider Electric Bulgaria Eood", shoqëria "Schneider Electric Industries Sas"

Mendimin Paralel të vendimit nr. 27, datë 19.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese.



SUBJEKT I INTERESUAR: Shoqëria “Amadeus Group” sh.a.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuëshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 62, datë 11.2.2015, të Gjykatës së Lartë;

Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 62, datë 11.2.2015, të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueseve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, shoqëria “Amadeus Group” sh.a., që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Shoqëria “Schneider Electric Bulgaria EOOD” (në vijim shoqëria “SEB EOOD”) është një shoqëri e themeluar dhe rregulluar sipas ligjit bullgar me seli në Sofje, Bullgari. Shoqëria “Schneider Electric Industries SAS” (në vijim shoqëria “SEI SAS”) është një shoqëri e themeluar dhe rregulluar sipas ligjit francez, me seli në Francë dhe zyrë përfaqësimi në Tiranë. Kërkuesi, shoqëria “SEI SAS” (shoqëria mëmë) është aksionar i kërkueses, Shoqërisë “SEB EOOD” (shoqëria bijë). Këto shoqëri kanë personalitete juridike të ndara nga njëra-tjetra.

2. Subjekti i interesuar, shoqëria “Amadeus Group” sh.a., është shoqëri e themeluar dhe e rregulluar sipas ligjit shqiptar. Në datën 18.4.2007, shoqëria “SEB EOOD” dhe subjekti i interesuar kanë lidhur ndërmjet tyre një marrëveshje distribucioni, si dhe një marrëveshje për kushtet e veçanta vjetore të vlefshme për vitin 2007. Shoqëria “SEI SAS” nuk ishte palë në asnjë prej këtyre marrëveshjeve.

3. Subjekti i interesuar ka dorëzuar padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar zgjidhjen e marrëveshjes së distribucionit dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga

mospërmbushja e detyrimit kontraktor, si dhe të dëmit për fitimin e munguar.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendim të ndërmjetëm të datës 1.6.2009, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “SEB EOOD” për nxjerrjen jashtë juridiksionit të çështjes në fjalë. Kjo kërkuese është ankuar ndaj këtij vendimi në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. 00-2009-1287, datë 27.10.2009, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke arsyetuar se palët kanë zgjedhur ligjin bullgar si ligj të zbatueshëm për çështjet e marrëveshjes së distribucionit, por jo juridiksionin e gjykatave bullgare.

5. Në lidhje me themelin e çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 12266, datë 12.12.2012 (nr. 12266/2012), ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë, konstatimin e zgjidhjes së marrëveshjes së distribucionit, detyrimin e shoqërisë “SEB EOOD” për t’i paguar subjektit të interesuar shumën 643,206 euro dhe rrëzimin e padisë për sa i përket shoqërisë “SEI SAS”.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 1864, datë 30.9.2013 (nr. 1864/2013), ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 12266/2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj.

7. Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs nga subjekti i interesuar dhe kundërrekurs nga kërkuestet. Kundërrekursi është dorëzuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 23.12.2013 (vërtetuar me kopjen e kundërrekursit të nënshkruar nga sekretaria e gjykatës së shkallës së parë, shkresën nr. 9917 prot., datë 24.7.2014 të kancelarit të gjykatës së shkallës së parë, shkresën nr. F-93/1 prot., datë 1.9.2015 të kancelarit të Gjykatës së Lartë, si dhe kopjen e parashtrimeve me shkrim të dorëzuar në Gjykatën e Lartë në datën 14.1.2015). Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 62, datë 11.2.2015 (nr. 62/2015), ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1864/2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 12266/2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me ndryshimin: “*detyrimin solidar të kërkueseve t’i paguajnë subjektit të interesuar shumën 643,206 euro*”.

II

8. **Kërkuestet** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar se ndaj



tyre është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në Gjykatën e Lartë. Më konkretisht, në kërkesën e tyre është parashtruar se janë cenuar:

8.1 E drejta për t'u dëgjuar, për shkak se Gjykata e Lartë nuk ka reflektuar në vendimin objekt shqyrtimi faktin se kërkuueset kanë dorëzuar një kundërrekurs, të cilin ajo nuk e ka shqyrtuar.

8.2 Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi Gjykata e Lartë jo vetëm nuk ka arsyetuar lidhur me rrëzimin e dy argumenteve kryesore të paraqitura nga kërkuueset, por arsytimi i dhënë prej saj është abstrakt, kundërthënës e irracional, duke mos e përmbushur detyrimin kushtetues të arsytimit të vendimeve gjyqësore.

8.3 E drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, për shkak se Gjykata e Lartë ka tejkuluar kompetencat e saj duke vendosur një detyrim mbi një shoqëri të huaj, e cila nuk kishte legjitimitet pasiv për të qenë palë në procesin gjyqësor.

8.4 E drejta e gjykimit kontradiktor nga një gjykatë e paanshme, për arsye se Gjykata e Lartë e ka bazuar vendimin në argumente që nuk janë parashtruar nga subjekti i interesuar, për të cilat kërkuueset nuk kanë pasur mundësi të shprehën.

9. Gjithashtu, kërkuueset, bazuar në nenin 45, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", kanë kërkuar edhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 62/2015, pasi ky ekzekutim do të sillte pasoja financiare të konsiderueshme dhe të pariparueshme për to.

10. **Subjekti i interesuar**, shoqëria "Amadeus Group" sh.a., ka parashtruar se:

10.1 Megjithëse në vendimin e Gjykatës së Lartë objekt shqyrtimi mungon formalisht pasqyrimi i faktit të paraqitjes së kundërrekursit nga kërkuueset, gjykata e ka shqyrtuar dhe argumentuar pjesën më të madhe të shkaqeve të ngritura në kundërrekurs. Kërkuueset, nga njëra anë, pranojnë se Gjykata e Lartë ka arsyetuar tri pika kyçe të ngritura prej tyre dhe, nga ana tjetër, pretendojnë se shkaqet e kundërrekursit nuk janë shqyrtuar nga ajo. Shkaqet që kërkuueset pretendojnë se nuk janë shqyrtuar nga Gjykata e Lartë kanë qenë të zgjidhura me vendim gjyqësor të formës së prerë. Kërkuueset e kanë pasur mundësinë për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur të

gjitha shkaqet e pasqyruara në kundërrekurs në parashtrimet me shkrim dhe verbalisht përpara Gjykatës së Lartë. Standardi i elaboruar nga Gjykata Kushtetuese në lidhje me mospasqyrimin e shkaqeve të pretenduara në vendim aplikohet në rastin e rekursit dhe jo të kundërrekursit.

10.2 Vendimi i Gjykatës së Lartë i përmbush standardet e kërkuara për arsytimin e vendimit gjyqësor. Ai nuk përmban kundërthënie, por ka interpretuar kushtet e kontratës së distribucionit dhe kushteve të veçanta të saj në përputhje me parimet e interpretimit të kontratës, sjelljes së palëve në tërësi, qëllimit të kontratës etj. Arsytimi i Gjykatës së Lartë është marrë nga kërkuueset i shkëputur nga konteksti. Gjykata e Lartë, ndryshe nga sa pretendojnë kërkuueset, ka treguar qartë ligjin ku mbështetet për përgjegjësinë solidare të tyre. Ky pretendim i kërkueseve ka të bëjë me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material nga ana e gjykatës.

10.3 Pretendimi i kërkueseve se Gjykata e Lartë nuk ka kompetencë për të gjykuar dhe dënua një shoqëri franceze për një dëm të shkaktuar nga një shoqëri bullgare në Republikën e Shqipërisë, është haptazi i pabazuar. Kjo për arsye se kemi të bëjmë me një shoqëri mëmë dhe një degë të saj, të cilat kanë të njëjtin personalitet juridik, ndaj detyrohen solidarisht për shpërblimin e dëmit nga mospërmbushja e detyrimit kontraktor. Në këtë rast, juridiksioni gjyqësor i gjykatës shqiptare është vendosur me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Lartë (vendimi nr. 340/2009).

10.4 Argumentet e paraqitura nga kërkuueset për cenimin e primeve të paanshmërisë dhe të kontradiktoritetit në gjykim janë të pambështetura. Parimi i "mirëbesimit kontraktor" është një parim i interpretimit të kontratës dhe si i tillë është përdorur nga Gjykata e Lartë për të analizuar dispozitat ligjore përkatëse.

10.5 Kërkesa për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 62/2015 nuk është e bazuar, pasi nuk ka asnjë të dhënë që kërkueseve u vijnë pasoja të pariparueshme financiare nga ky ekzekutim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueseve



11. Kërkueset legjitimohen *ratione personae* në lidhje me pretendimet e tyre, të cilat i kanë paraqitur në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

12. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkueset kanë ngritur pretendime të cilat *prima facie* kanë të bëjnë me të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Në vijim janë shqyrtuar pretendimet e paraqitura nga kërkueset.

B. Për kërkesën e pezullimit të ekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Lartë

13. Kërkueset kanë kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 62/2015, pasi sipas tyre ekzekutimi do të sillte pasoja të rënda dhe të pariparueshme për to. Nevoja për pezullimin e vendimit lidhet me rastin e paprecedent të cenimit të interesave të subjekteve të huaja, edhe pse nuk janë palë në një marrëdhënie juridike, për shkak të një vendimi gjyqësor, i cili, sipas kërkueseve, është haptazi i paligjshëm dhe diskriminues. Sipas parashtrimeve të kërkueseve, subjekti i interesuar në muajin gusht 2015 ka nisur në Francë procedurën e ekzekutimit të vendimit nr. 62/2015 të Gjykatës së Lartë, ndaj, sipas tyre, ky fakt e bën urgjent pezullimin e këtij vendimi.

14. Mbledhja e Gjyqtarëve mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 62/2015 të paraqitur nga kërkueset dhe vlerësoi se kjo kërkesë nuk i plotëson kriteret e përcaktuara nga neni 45 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Për rrjedhojë, ajo vendosi rrëzimin e kësaj kërkesë si të pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor lidhur me të drejtën për t’u dëgjuar dhe parimin e kontradiktoritetit në gjykim

15. Kërkueset kanë pretenduar se është cenuar e drejta për t’u dëgjuar, për shkak se Gjykata e Lartë nuk ka reflektuar në vendimin objekt shqyrtimi faktin se kërkueset kanë dorëzuar një kundërrekurs, të cilin ajo nuk ka

shqyrtuar. Në vendimin nr. 62/2015 Gjykata e Lartë, pasi përshkruan faktet dhe procedurën, përmend në mënyrë kronologjike vendimin nr. 12266/2012, vendimin nr. 1864/2013, rekursin e paraqitur nga subjekti i interesuar dhe më pas kalon te pjesa e arsyetimit pa përmendur argumentet e parashtruara në kundërrekurs dhe shpjegimet me shkrim të depozituara nga përfaqësuesit e kërkueseve në seancën gjyqësore. Gjithashtu, kërkueset kanë pretenduar cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi Gjykata e Lartë jo vetëm nuk ka arsyetuar lidhur me rrëzimin e dy argumenteve kryesore të paraqitura nga kërkueset, por arsyetimi i dhënë prej saj është tepër abstrakt, kundërthënës e irracional, duke mos e përmbushur detyrimin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore.

16. Gjykata është shprehur se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 79, datë 28.12.2015; nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 8, datë 16.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur apo të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në



aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 79, datë 28.12.2015; nr. 20, datë 13.4.2012; nr. 38, datë 30.12.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin konkret vendimi nr. 62/2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përmban në pjesën hyrëse të tij objektin e padisë, disponimet e gjykatës së shkallës së parë, disponimet e gjykatës së apelit, faktin se kundër vendimit të kësaj të fundit ka paraqitur rekurs subjekti i interesuar, si dhe shkaqet që ai ka parashtuar në rekurs. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës konstatohet se kërkuueset kanë paraqitur kundërrekurs. Në vendimin e Gjykatës së Lartë nuk është pasqyruar ky fakt dhe as shkaqet e kundërrekursit. Megjithatë, vetëm mosparaqitja e shkaqeve të kundër-rekursit në vendim nuk e bën procesin të parregullt, në këndvështrim të standardit të arsyetimit, si dhe parimit të kontradiktoritetit e barazisë së armëve. Gjykata arrin në këtë konkluzion pasi e ka vlerësuar në tërësi procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë. Jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, për të investuar Gjykatën Kushtetuese. Ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit dhe çdo të drejtë tjetër të njohur me Kushtetutë dhe me ligj (*shih vendimin nr. 9, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga materialet në dosjen gjyqësore rezulton se në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë kërkuueset kanë qenë prezent, si dhe kanë paraqitur parashtrimet e tyre me shkrim për të kundërshtuar pretendimet e rekursit. Për këto arsye, në vlerësimin e Gjykatës vendimi nr. 62/2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë i ka

plotësuar mjaftueshëm kriteret e përcaktuara më sipër nga jurisprudenca kushtetuese, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar.

20. Bazuar mbi këto parime dhe rrethana faktike, Gjykata çmon se pretendimi i kërkueseve për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe parimin e kontradiktoritetit në gjykim, nuk është i bazuar dhe nuk duhet të pranohet⁴.

Ç. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj

21. Kërkuueset kanë pretenduar se është cenuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, për shkak se Gjykata e Lartë ka tejkaluar kompetencat e saj duke vendosur një detyrim mbi një shoqëri të huaj, e cila nuk kishte legjitimitet pasiv për të qenë palë në procesin gjyqësor. Gjykata e shkallës së parë ka vendosur pushimin e gjykimit për kërkuesen, shoqërinë "SEI SAS", pasi subjekti i interesuar (paditësi) ka hequr dorë nga gjykimi për këtë të paditur, duke kërkuar pushimin e gjykimit për të. Sipas kërkueseve, Gjykata e Lartë i është referuar në arsyetim kryesisht "parimit të mirëbesimit kontraktor", i cili nuk është ngritur në shkaqet e rekursit nga subjekti i interesuar. Arsyetimi i saj mbështetet mbi këtë term juridik për të cilin kërkuueset nuk kanë pasur mundësi të komentojnë në kundërrekurs.

22. Gjykata ka theksuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është dhe shqyrtimi i çështjes nga një "*gjykatë e caktuar me ligj*". Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur

⁴ Gjyqtarët S.Berberi dhe F.Lulo votuan për pranimin e këtij pretendimi



nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 2, datë 22.1.2014; nr. 27, datë 24.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, të sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, Gjykata ka vlerësuar se kompetenca e saj për shqyrtimin e çështjeve nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale, të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Në nocionin kushtetues të rishikimit futet, në radhë të parë, shqyrtimi i rekurseve për pretendimet e shkeljes të ligjit material ose procedural, gjë që përbën funksionin kryesor të Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 31, datë 1.12.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Sipas jurisprudencës kushtetuese procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 7, datë 9.3.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtësi të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat e faktit. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë ose të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin në fakt. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, në kuptim të nenit 485 të KPC-së, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në çështjen konkrete rezulton se subjekti i interesuar gjatë gjykimit në shkallë të parë ka

hequr dorë nga gjykimi për kërkuesen shoqërinë “SEI SAS”, ndaj gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit për të (*shih f. 3 të vendimit nr. 12266/2012*). Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë është shprehur në vendim se kjo shoqëri nuk ka qenë palë në kontratën e distribucionit, ndaj ka çmuar se padia për të duhet të rrëzohej. Sipas saj, dëmshpërblimi në vlerën 643,206 euro duhet të paguhej nga kërkuesja shoqëria “SEB EOOD” (*shih f. 13 të vendimit nr. 12266/2012*). Edhe Gjykata e Apelit e ka quajtur të drejtë konstatimin e gjykatës së shkallës së parë se kërkuesja shoqëria “SEI SAS” nuk ka qenë palë në kontratën e distribucionit (*shih f. 13 të vendimit nr. 1864/2013*). Ndërsa Gjykata e Lartë, pasi ka lënë në fuqi vendimin nr. 12266/2012 të gjykatës të shkallës së parë është shprehur se: “Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke arritur në përfundimin se paditëses i është shkaktuar një dëm [...] vlerëson se në këtë rast jemi përpara një shoqërie “bijë”, sikundër është “Schneider Electric Bulgaria EOOD”, dhe si e tillë ajo duhet të përgjigjet në lidhje me dëmin e shkaktuar së bashku me shoqërinë “mëmë”, që është shoqëria “Schneider Electric Industries SAS”. Në çështjen objekt shqyrtimi jemi përpara rastit të një detyrimi solidar pasiv të krijuar nga kontrata dhe ligji në të cilin palët e paditura shfaqen në cilësinë e debitorëve solidarë, kurse në anën e kreditorit shfaqet si i tillë paditësi. Duke qenë para një rasti të tillë secili debitor përgjigjet për borxhin ndaj kreditorit dhe kreditori sipas ligjit është i autorizuar që prej secilit debitor të kërkojë përmbushjen e detyrimit. Në rastin në shqyrtim përgjegjësia solidarë është krijuar mbi baza dhe shkak juridik të ndryshëm [...]. Për palën e paditur, shoqëria “Schneider Electric Industries SAS”, përgjegjësia solidarë rrjedh nga ligji për shkak të qenies shoqëri “mëmë”. Në konfliktin e sjellë para gjykatës dëmi është shkaktuar nga njëra prej të paditurave [...] dhe në një kohë që është e pamundur të vërtetohet se cila prej tyre e ka shkaktuar dëmin, ligji ka parashikuar mundësinë që ato të përgjigjen solidarisht”.

26. Nga sa më sipër është e qartë se Gjykata e Lartë ka arsyetuar ndryshe nga gjykata e shkallës së parë, vendimin e së cilës ka lënë në fuqi, për sa i përket legjitimitetit pasiv të shoqërisë “SEI SAS”, duke mos e marrë në konsideratë faktin se vetë subjekti i interesuar gjatë gjykimit në shkallë të parë kishte hequr dorë nga gjykimi për kërkuesen, shoqërinë “SEI SAS”. Jo vetëm kaq, por Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka arritur në përfundimin se kjo shoqëri duhej të përgjigjej



solidarisht për pagimin e dëmit të shkaktuar pa iu referuar kontratës së distribucionit. Këtë arsyetim ajo e ka mbështetur në raportin bijë/mëmë që ekziston midis kërkueseve, si dhe në ligj, por pa përmendur se cilit ligj i referohet për të arritur në përfundimin se kërkueset duhet të përgjigjen solidarisht në lidhje me shpërblimin e dëmit kontraktor. Për më tepër, Gjykata e Lartë duket sikur i shmanget në vendim interpretimit tekstual të neneve të kontratës dhe referimit në to duke i mbështetur konkluzionet në një interpretim të kontratës sipas sjelljes e qëllimit të palëve, sipas kuptimit që kanë dashur t'i japin palët kontratës, sipas kuptimit më të favorshëm për kontraktuesin më të dobët në rastin e shprehjeve me dy kuptime, parimit të mirëbesimit kontraktor etj. (*shih f. 12–15 të vendimit nr. 62/2015*).

27. Nisur nga analiza e mësipërme dhe duke iu referuar standardeve kushtetuese, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueseve për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, është i bazuar dhe duhet pranuar.

D. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së gjykimit nga një gjykatë e paanshme

28. Kërkueset kanë pretenduar se është cenuar e drejta e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, për arsye se Gjykata e Lartë e ka bazuar vendimin në argumente që nuk janë parashtruar nga subjekti i interesuar, siç është parimi i mirëbesimit kontraktor, mbi të cilat kërkueset nuk kanë pasur mundësi të shprehur.

29. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimin nr. 49, datë 10.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në lidhje me këtë pretendim të kërkueseve, Gjykata vlerëson se argumentet e tyre nuk janë ngritur në nivel kushtetues që të shqyrtohen prej saj.

31. Si përfundim, bazuar në sa më sipër, në kuptim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueseve për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si i papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 62, datë 11.2.2015, të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Sokol Berberi, Fatos Lulo

MENDIM PARALEL

1. Në çështjen me kërkuese shoqërinë “SEB EOOD” dhe shoqërinë “SEI SAS” ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën për pranimin e pretendimit të cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, por gjykojmë se ajo duhej të pranonte edhe pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar, që në vlerësimin tonë është i bazuar. Për këtë arsye e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim paralel.

2. Kërkueset kanë pretenduar se është cenuar e drejta për t'u dëgjuar, për shkak se Gjykata e Lartë nuk ka reflektuar në vendimin objekt shqyrtimi faktin se kërkueset kanë dorëzuar një kundërrekurs, të cilin ajo nuk ka shqyrtuar. Gjithashtu, kërkueset kanë pretenduar cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi Gjykata e Lartë jo vetëm nuk ka arsyetuar lidhur me rrëzimin e dy argumenteve kryesore të



paraqitura nga kërkueset në kundërrekurs, por arsyetimi i dhënë prej saj është tepër abstrakt, kundërthënës e irracional, duke mos e përmbushur detyrimin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Në lidhje me këtë pretendim shumica është shprehur se “vetëm mosparaqitja e shkaqeve të kundërrekursit në vendim nuk e bën procesin të parregullt në këndvështrim të standardit të arsyetimit, si dhe parimit të kontradiktoritetit e barazisë së armëve. Gjykata arrin në këtë konkluzion, pasi e ka vlerësuar në tërësi procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë. Në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë kërkueset kanë qenë prezent, si dhe kanë paraqitur parashtrimet e tyre me shkrim për të kundërshtuar pretendimet e rekursit. Për këto arsye, në vlerësimin e Gjykatës vendimi nr. 62/2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë i ka plotësuar mjaftueshëm kriteret e përcaktuara më sipër nga jurisprudenca kushtetuese, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (§ 19 i vendimit).

3. Nuk pajtohem me këtë qëndrim të shumicës për arsyet në vijim.

4. Siç është shprehur edhe shumica, e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (§ 16 i vendimit).

5. Nga përmbajtja e vendimit nr. 62/2015 të Gjykatës së Lartë rezulton se në të nuk është pasqyruar as fakti që kërkueset kanë paraqitur kundërrekurs dhe as shkaqet e kundërrekursit. Po kështu edhe në pjesën arsyetuese, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë u është referuar vetëm shkaqeve të parashtruara në rekurs nga subjekti i interesuar, të cilat i ka vlerësuar në seancë gjyqësore dhe më pas ka arritur në konkluzionin e shprehur në dispozitiv.

6. Kundërrekursi është një mjet juridik me anë të së cilit një palë ndërgjyqëse realizon të drejtën për t'u dëgjuar, në respektim të parimit të barazisë dhe kontradiktoritetit në gjykim. Sipas nenit 477 të KPC-së, pala kundër së cilës është paraqitur rekursi, mund ta kundërshtojë atë me

kundërrekurs. Shkaqet e paraqitura në kundërrekurs përbëjnë një element të rëndësishëm të përmbajtjes së vendimit gjyqësor, që tregon se Gjykata e Lartë i ka marrë parasysh pretendimet e palës për të kundërshtuar rekursin, në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve. Nga aktet e administruara rezulton se kërkueset kanë marrë dijeni për rekursin në datën 12.12.2013 dhe kanë paraqitur kundërrekurs në gjykatën përkatëse në datën 23.12.2013 (vërtetuar me kopjen e kundërrekursit të nënshkruar nga sekretaria e gjykatës së shkallës së parë; shkresën nr. 9917 prot., datë 24.7.2014 të kancelarit të gjykatës së shkallës së parë; shkresën nr. F-93/1 prot., datë 1.9.2015 të kancelarit të Gjykatës së Lartë; kopjen e parashtrimeve me shkrim të dorëzuar në Gjykatën e Lartë në datën 14.1.2015).

7. Në jurisprudencën konstante të Gjykatës mungesa e paraqitjes së shkaqeve të rekursit në vendimin e Gjykatës së Lartë përbën një të metë të pakapërcyeshme të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës. Në të tilla raste Gjykata është shprehur se rrjedha logjike e përdorur në vendim nuk rezulton e qartë dhe e kuptueshme dhe se argumentet e pjesës hyrëse nuk janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese. Ato nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, çka bën që përmbajtja dhe arsyetimi i tij të mos kenë një harmoni të brendshme. Gjykata në të tilla raste ka çmuar, gjithashtu, se, *prima facie*, mosparaqitja në vendimin e Kolegjit Civil e shkaqeve të parashtruara nga kërkuesi në rekurs, krijon dyshime edhe mbi cenimin e së drejtës së ankimit efektiv. Në këtë këndvështrim, pasqyrimi i shkaqeve të rekursit në pjesën hyrëse të vendimit përbën një element të domosdoshëm dhe të rëndësishëm të tij, i cili nuk ka thjesht karakter formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor. Është detyrë e Gjykatës së Lartë të bëjë të mundur realizimin efektiv të së drejtës së aksesit, pa lënë shkas për ekuivoqe në lidhje me marrjen në shqyrtim dhe vlerësimin e pretendimeve të kërkuesve nga ana e saj (*shih vendimet nr. 29, datë 22.5.2015; nr. 26, datë 24.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Duke iu kthyer çështjes konkrete, vëmë në dukje se në vendimin nr. 62/2015 të Gjykatës së



Lartë mungon tërësisht pasqyrimi i faktit që kërkueset kanë paraqitur kundërrekurs, si dhe i shkaqeve të këtij kundërrekursi. Gjithashtu, në dosjen e Gjykatës së Lartë nuk rezulton i administruar kundërrekursi, megjithëse përmendet si në parashtrimet me shkrim të kërkueseve, ashtu edhe në ato të subjektit të interesuar. Këto rrethana faktike krijojnë dyshime se prapësimet e kërkueseve në lidhje me rekursin nuk janë marrë parasysh nga Gjykata e Lartë. Nga përmbajtja e vendimit nuk konstatohet që Gjykata e Lartë të ketë përmendur apo t'i ketë dhënë përgjigje ndonjërit prej pretendimeve të ngritura në kundërrekurs. Megjithëse në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se detyrimi që ka gjykata për të arsyetuar vendimet e saj nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse, kjo nuk do të thotë se pretendimet kundërshtuese të palës, e cila kundërshton rekursin, të mos merren parasysh nga gjykata dhe të mos gjejnë asnjë pasqyrim në vendimin e saj. Mosparaqitja në vendimin e Kolegjit Civil e shkaqeve të ngritura nga kërkueset në kundërrekurs, e parashtrimeve me shkrim të paraqitura me anë të notës verbale, si dhe mos dhënia përgjigje asnjërës prej prapësimeve të tyre, cenon rregullsinë e procesit në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor në lidhje edhe me të drejtën për t'u dëgjuar.

9. Në këto kushte vlerësojmë se vendimi nr. 62/2015 i Gjykatës së Lartë nuk i plotëson mjaftueshëm standardet e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe, për rrjedhojë, pretendimi i kërkueseve në këtë drejtim është i bazuar dhe duhej pranuar nga shumica.

Anëtarë: Fatos Lulo, Sokol Berberi

VENDIM

Nr. 31, datë 23.5.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 23.9.2015, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 42/7 Akti, që u përket:

KËRKUESE: Mirela Sinani

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Kulturës, Teatri Kombëtar i Operës Baletit dhe Ansamblit Popullor

OBJEKTI: Shfuqizimi pjesërisht si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 2080, datë 23.3.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 792, datë 15.4.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2011-296, datë 6.4.2011, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi); nr. 00-2014-18, datë 15.1.2014, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 18/1, 41/1, 41/5, 42, 43 dhe 58 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 7 dhe 8 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesja është krijuese e libretit të operës “Dhoma”, e cila është vënë në skenë nga Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor (TKOBAP) në vitin 2004. Ky projekt është mbështetur financiarisht nga fondet artistike të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, e cila, me urdhrin nr. 305, datë 8.10.2004, ka vendosur: “Të mbështesë financiarisht me shumën 1 115.000 lekë vënien në skenë të operës “Dhoma” të kompozitorit E.D.”, prej të cilave 100.000 lekë i janë paguar kompozitorit, kurse pjesa e mbetur ka kaluar për skenografinë. Shpenzimet artistike dhe ato teknike janë përballuar nga TKOBAP-i.



2. Duke pretenduar të drejtën për t'u shpërblyer për përdorimin e krijimtarisë artistike, kërkesja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt *“Dëmshtëpërblym nga përdorimi i pronësisë artistike në shumën 2.000.000 lekë, shpërblym për fitimin e munguar, shpërblym për dëmin e shkaktuar nga cenimi në nderin dhe personalitetin”*.

3. Me vendimin nr. 2080, datë 23.3.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur *“Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë. Detyrimin e palës së paditur, Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit, të shpërblejë paditësen për përdorimin e pronësisë artistike në vlerën 571.365 lekë, si dhe fitimin e munguar të kësaj shume për periudhën nga 9.5.2004 deri më 20.10.2006 në vlerën 74.378 lekë dhe pas kësaj date në vlerën 83.19 lekë çdo ditë. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër[...]*”.

4. Me vendimin nr. 792, datë 15.4.2008, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Me vendimin nr. 00-2011-296, datë 6.4.2011, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkesja, me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC). Vendimet e mësipërme të tri shkallëve të gjyqimit janë kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese.

6. Me vendimin nr. 51, datë 21.11.2013, Gjykata Kushtetuese ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës, duke shfuqizuar vendimin nr. 00-2011-296, datë 6.4.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë.

7. Pas rishqyrtimit të rekursit në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2014-18, datë 15.1.2014, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, për arsye se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së.

II

8. **Kërkesja Mirela Sinani** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë sipas objektit, duke parashtruar këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

8.1 Pas kthimit të çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë vendimi është riformuluar nga pikëpamja formale referuar vërejtjeve të Gjykatës

Kushtetuese, duke u pajisur me pjesën hyrëse, por ai shpreh indiferencë ndaj shkeljeve procedurale në gjykimet e zhvilluara në shkallët e tjera të gjyqimit, si edhe nuk zgjidh problemin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

8.2 Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë ligji, duhej të shprehej për pretendimet e paraqitura në rekurs nga kërkesja, që kanë të bëjnë si me keqzbatimin e ligjit, ashtu edhe me shkeljet procedurale të kryera nga gjykatat më të ulëta.

8.3 Gjykata e Shkallës së Parë ka shkelur nenin 106 të KPC-së që shpenzimet gjyqësore ia ngarkon palës së paditur në masën e pjesës së padisë të pranuar nga gjykata, duke vendosur që të gjitha shpenzimet t'i lerë në ngarkim të palës paditëse.

8.4 Gjykata e Apelit jo vetëm që nuk ka kryer njoftimin e palëve, por në mungesë të tyre nuk ka kryer asnjë shqyrtim gjyqësor të çështjes. Nga pikëpamja kohore vendimi është nxjerrë në të njëjtën ditë kur do të zhvillohej seanca e shqyrtimit gjyqësor, kurse nga pikëpamja e formulimit ai është i njëjtë me atë të gjykatës të shkallës së parë, pa u korrigjuar kontradiktat e arsytimit të këtij të fundit dhe pa u dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura për atë gjykim.

8.5 Mospranimi i çështjes në Gjykatën e Lartë ka ligjëruar faktikisht shqyrtimin e çështjes vetëm në shkallë të parë, me një vendim që i jep palës fituese një shpërblym jashtë çdo standardi ligjor dhe në pozita të pabarabarta në raport me bashkautorin tjetër të veprës.

9. **Subjekti i interesuar, Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor**, ka propësuar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

9.1 Në bazë të vendimeve të gjykatave TKOBAP-ja ka filluar shlyerjen e detyrimit ndaj kërkeses, duke derdhur çdo muaj, në formën e kësteve pjesore mujore, shumën prej 10.000 lekësh në muaj në çdo datë 1 të muajve në vijim për vitin 2013.

9.2 TKOBAP-ja ka likuiduar pagesën e fundit ndaj kreditorit Mirela Sinani me urdhrin e datës 14.5.2015. Pra, në mbështetje të vendimeve të gjykatave ka shlyer të gjitha detyrimet që i ishin ngarkuar si palë në gjykim.



III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkujes

10. Gjykata vlerëson se kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30, pika 2, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata rithekson se kërkuësja i është drejtuar edhe më parë asaj me pretendime për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke kundërshtuar disa nga vendimet të cilat janë sërish objekt i kërkesës në shqyrtim. Me vendimin nr. 51, datë 21.11.2013, Gjykata vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës, duke shfuqizuar vendimin nr. 00-2011-296, datë 6.4.2011 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, për shkak të cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjykata vlerësoi se “mosparaqitja në vendimin e Kolegjit Civil të shkaqeve të parashtruara nga kërkuësja në rekurs, *prima facie*, krijon dyshime edhe mbi cenimin e së drejtës së ankimit efektiv, si dhe të drejtës për t’u dëgjuar, të pretenduara edhe nga vetë kërkuësja. Në këtë vështrim, pasqyrimi i shkaqeve të rekursit në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë përbën një element të domosdoshëm dhe të rëndësishëm të tij, i cili nuk ka thjesht karakter formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor” (*shih paragrafin 24 të vendimit*).

12. Në lidhje me pretendimet e tjera të ngritura në atë kërkesë Gjykata, gjithashtu, ka mbajtur një qëndrim të shprehur në vendimin e sipërcituar. Pretendimin e kërkuësës për mosnjohimin e saj për gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Apelit, Gjykata e ka vlerësuar të pabazuar, kurse pretendimet e tjera që kanë të bëjnë me mosrespektimin e parimit të barazisë së armëve, afatin e arsyeshem të gjykimit etj., janë vlerësuar se nuk i përkasin juridiksionit kushtetues, pasi kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave, si dhe me mënyrën e interpretimit të fakteve dhe të zbatimit të ligjit

nga ana e gjykatave të zakonshme. Në këto kushte, për sa kohë pretendimet e kërkuësës që lidhen me procesin e zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë dhe atë të Apelit i janë nënshtruar edhe më parë gjykimit kushtetues dhe kanë marrë përgjigje në vendimin nr. 51, datë 21.11.2013, kërkuësja nuk legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës për këto pretendime, por vetëm për pretendimet që paraqiten rishtazi para Gjykatës dhe që i referohen procesit të zhvilluar në Gjykatën e Lartë pas kthimit të çështjes për rishqyrtim.

B. Për procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë

13. Kërkuësja pretendon se pas kthimit të çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë vendimi është pajisur vetëm me pjesën hyrëse, por pa u dhënë përgjigje shkeljeve procedurale të kryera në gjykatat e faktit, edhe pse kjo është në funksionin e saj si gjykatë ligji. Sipas kërkuësës, mospranimi i rekursit ka ligjëruar faktikisht shqyrtimin e çështjes vetëm në shkallë të parë, me një vendim që i jep palës fituese një shpërblym jashtë çdo standardi ligjor dhe në pozita të pabarabarta në raport me bashkautorin tjetër të veprës.

14. Në nenin 42/2 të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshem nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila do t’i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi



konsiderohet i parregullt, sepse akses i në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimin nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në nenin 472 të KPC-së janë parashikuar shkaqet për të cilat mund të paraqitet rekurs, kurse në nenin 480 të KPC-së parashikohet se rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji ose nuk plotëson kërkesat procedurale dhe se mospranimi i tij vendoset nga Kolegji i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit pa pjesëmarrjen e palëve. Kolegji i Gjykatës së Lartë është organi që analizon dhe vlerëson nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit, duke vlerësuar kështu nëse rekursi përmban shkaqe për t'u kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore. Në jurisprudencë konstante, Gjykata ka theksuar se në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato shkaqe që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e së drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës, por një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Nga pikëpamja kushtetuese vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit civil, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i Kolegjit Civil për mospranimin e rekursit vë në dyshim të

drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 6, datë 10.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo, sepse referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport midis juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimin nr. 52, datë 2.12.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Gjykata rithekson se zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj është i garantuar nga Kushtetuta, e cila në nenet 132 dhe 145 të saj sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Vendimet e Gjykatës kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Në respekt të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese, Gjykata ka theksuar se efekti detyrues që pasqyrohet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj përbën edhe një *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë. Nga kjo pikëpamje Gjykata ka theksuar se nga standardi i detyrimit të zbatimit të vendimarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vet Gjykata Kushtetuese (*shih vendimin nr. 44, datë 29.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Duke vlerësuar zbatimin e standardeve të mësipërme gjatë shqyrtimit të çështjes konkrete, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë i ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga vendimi nr. 51, datë 21.11.2013 për të zhvilluar një proces të rregullt ligjor gjatë rishqyrtimit të çështjes në po atë gjykatë. Në zbatim të vendimit detyrues të Gjykatës, Gjykata e Lartë, në përputhje me kompetencat e saj ligjore, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekurs, ka vlerësuar se ato nuk përfshihen në asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 472 të KPC-së, duke e arsyetuar qëndrimin e saj në vendimin e kundërshtuar. Në kushtet kur nuk ka pretendime



të natyrës kushtetuese, vetëm fakti i shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit nuk është i mjaftueshëm për të konkluduar se procesi gjyqësor nuk ka qenë i rregullt nga pikëpamja kushtetuese. Po ashtu, në vlerësimin e Gjykatës arsyetimi i vendimit nr. 00-2014-18, datë 15.1.2014, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk paraqet ndonjë mangësi, e cila mund të ndikojë në cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Kjo formë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimin të rekursit nga ana e Kolegjit Civil në dhomë këshillimi (*shih vendimin nr. 6, datë 10.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarës për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, janë të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72, 77 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Sokol Berberi, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

Anëtar kundër: Vladimir Kristo

Anëtare pjesërisht kundër: Vitore Tusha

VENDIM

Nr. 1, datë 29.2.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga gjyqtarët:

Xhezair Zaganjori	kryesues	“	“
Ardian Dvorani	anëtar i	“	“
Ardian Nuni	anëtar i	“	“
Aleksandër Muskaj	anëtar i	“	“

Majlinda Andrea	anëtare e	“	“
Arjana Fullani	anëtare e	“	“
Evelina Qirjako	anëtare e	“	“
Guxim Zenelaj	anëtar i	“	“
Andi Çeliku	anëtar i	“	“
Mirela Fana	anëtare e	“	“
Medi Bici	anëtar i	“	“
Edmond Islamaj	anëtar i	“	“
Shkëlzen Selimi	anëtar i	“	“
Artan Zeneli	anëtar i	“	“
Admir Thanza	anëtar i	“	“
Tom Ndreca	anëtar i	“	“
Artan Broci	anëtar i	“	“

asistuar nga sekretarja Ermelinda Kadiu, sot në datën 29.2.2016, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen administrative që iu përket palëve:

PADITËS: Polikron Zyba (në mungesë).

I PADITUR: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, përfaqësuar në gjyq nga juristja Borianna Nikolla.

Ministria e Brendshme, përfaqësuar në gjyq nga Av. Shtetit Lorana Kasapi.

Me pjesëmarrjen e Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit, përfaqësuar në gjyq nga Av. Shtetit Lorana Kasapi.

OBJEKTI: Anulimi pjesërisht i aktit administrativ, urdhrit nr. 319/8, datë 24.11.2006, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “inspektor”, paditësit Polikron Zyba.

Anulimi pjesërisht i aktit administrativ, urdhrit nr. 142, datë 22.1.2007, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “inspektor”, paditësit Polikron Zyba.

Anulimi pjesërisht i aktit administrativ, urdhrit nr. 142/1, datë 10.12.2007, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “inspektor”, paditësit Polikron Zyba.

Anulimi pjesërisht i aktit administrativ, urdhrit nr. 732/1, datë 25.3.2008, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “inspektor”, paditësit Polikron Zyba.

Anulimi pjesërisht i aktit administrativ, urdhrit nr. 5290/1, datë 7.9.2011, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “nënkomisar”, paditësit Polikron Zyba.



Anulimi pjesërisht i aktit administrativ, urdhrit nr. 43, datë 17.6.2008, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “n/inspektor”, paditësit Polikron Zyba.

Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, t’i njohë paditësit Polikron Zyba gradën policore “komisar” dhe të gjitha të drejtat që rrjedhin nga kjo gradë, nga data 17.6.2008 e në vijim.

BAZA LIGJORE: Nenet 32, 153, 154 e vijues, 324, e vijues të Kodit të Procedurës Civile; ligji nr. 8643, datë 20.7.2000, “Për gradat në Policinë e Shtetit”; vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 64, datë 2.2.2001, “Për inkadrimin e gradave ushtarake, në gradat e Policisë së Shtetit dhe për përcaktimin e funksioneve, që do të ushtrohen sipas tyre”; ligji nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit”; vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 803, datë 21.11.2007, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre”; Kodi i Procedurave Administrative dhe nenet 44, 49, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4937, datë 6.5.2013, ka vendosur:

Pranimin e kërkesëpadisë.

Anulimin pjesërisht të aktit administrativ, urdhrit nr. 319/8, datë 24.11.2006, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “inspektor”, paditësit Polikron Zyba.

Anulimin pjesërisht të aktit administrativ, urdhrit nr. 142, datë 22.1.2007, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “inspektor” paditësit Polikron Zyba.

Anulimin pjesërisht të aktit administrativ, urdhrit nr. 142/1, datë 10.12.2007, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “inspektor”, paditësit Polikron Zyba.

Anulimin pjesërisht të aktit administrativ, urdhrit nr. 732/1, datë 25.3.2008, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “inspektor”, paditësit Polikron Zyba.

Anulimin pjesërisht të aktit administrativ, urdhrit nr. 5290/1, datë 7.9.2011 të drejtorit të

përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “nënkomisar”, paditësit Polikron Zyba.

Anulimin pjesërisht të aktit administrativ, urdhrit nr. 43, datë 17.6.2008, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “n/inspektor”, paditësit Polikron Zyba.

Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, t’i njohë paditësit Polikron Zyba gradën policore “komisar” dhe të gjitha të drejtat që rrjedhin nga kjo gradë, nga data 17.6.2008 e në vijim.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2362, datë 5.11.2013, ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 4937, datë 6.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ndaj vendimit të sipërcituar rezulton të ketë paraqitur rekurs pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, e cila kërkon:

Ndryshimin e vendimit nr. 2362, datë 5.11.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr. 4937, datë 6.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Shkaqet që pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit paraqet në rekurs, janë:

- Së pari, dhe më thelbësorja, duhet të theksojmë se mbështetur në nenin 126, pika 7, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit”, paditësit i është parashkruar kjo e drejtë dhe konkretisht neni citon: Punonjësi i policisë ka të drejtë që brenda 30 ditëve nga marrja dijeni, të ankohet për gradën e marrë tek eprori i autoritetit që i ka dhënë gradën ose drejtpërdrejt në gjykatë.

- Paditësit kjo e drejtë i është parashkruar, pasi ai gradën “nënkomisar” e ka marrë në vitin 2008 dhe kërkon rifitimin e kësaj të drejte në vitin 2013. Duke pasur parasysh faktin se paditësi ka marrë dijeni për këtë gradë dhe duke marrë të mirëqenë faktin se ai i ka ditur afatet e ankimit për gradën e dhënë, atëherë kjo e drejtë e tij është qartësisht e parashkruar.

- Në momentin e dhënies së gradës Komisionet Kalimtare, mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 803, datë 21.11.2007, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre”, kanë marrë parasysh dy



kritere, të cilat janë funksioni dhe vjetërsia në punë që nevojitet për marrjen e gradës që i korrespondon funksionit. Paditësi në momentin e dhënies së gradës “nënkomisar” ka qenë me detyrë specialist informacioni, në Seksionin e Kontrollit të Territorit, në Komisariatin e Policisë nr. 6 Tiranë, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë. Mbështetur dhe në tabelën e ekuivalentimit të gradave dhe funksioneve në momentin e marrjes së gradës “nënkomisar” paditësi ka mbajtur gradën “nëninspektor”.

- Pra, konkretisht mbështetur në bazën ligjore të sipërcituar mendojmë se urdhrat objekt padie të drejtorit të përgjithshëm të Policisë janë të mbështetur në ligj dhe në prova dhe grada që i është dhënë paditësit është grada e merituar.

- Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë kanë këto të meta serioze: Nuk është respektuar ose është zbatuar keq ligji dhe nuk janë marrë parasysh faktet dhe provat e paraqitura nga ana e DPPSH-së.

- Në asnjë moment gjatë gjykimit, si dhe në vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Tiranë nuk u mor parasysh fakti se, paditësi kishte dijeni për gradën e dhënë dhe mund të ankimonte administrativisht dhe gjyqësish brenda afateve ligjore.

- Në asnjë moment gjatë gjykimit nuk u mor parasysh se, e drejta e paditësit për të ngritur padi me objektin e sipërcituar është e parashkuar.

Me vendimin e datës 19.1.2016, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ka vendosur:

Dërgimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për njehsimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore.

Kolegji Administrativ ka parashtruar për zgjidhje përpara Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, çështjet e mëposhtme:

1. Cilat duhet të jenë kriteret ligjore që duhet të merren parasysh për caktimin e gradës së re, në rastin e ekuivalentimit të gradave policore, të dhëna sipas ligjit nr. 8643, datë 20.7.2000, “Për gradat në Policinë e Shtetit” (i shfuqizuar), ose me ligje të tjera të mëparshme me gradat e reja policore, të parashikuara nga ligji nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit” dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 803, datë

21.11.2007, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre”?

2. Nëse punonjësi i policisë, të cilit i është dhënë një gradë më e ulët se grada që i korrespondonte atij në tabelën e gradave, ka vazhduar të punojë, duke u paguar me gradën e re, të cilën ai e kundërshton, a do të konsiderohet ky fakt si marrje dijeni për aktin administrativ me të cilin është bërë ekuivalentimi i gradës policore?

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS
SË LARTË

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Medi Bici dhe Mirela Fana; përfaqësuesen e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, juristen Borianë Nikolla dhe përfaqësuesen e Avokaturës së Përgjithshme të Shtetit Av. Lorana Kasapi, të cilat kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë; e biseduan çështjen në tërësi, në përfundim,

VËREJNË:

1. Në Gjykatën e Lartë, në datën 27.1.2014 është regjistruar çështja administrative nr. 31001-00320-00-2014 regj. Them., që u përket palëve: paditës Polikron Zyba dhe të paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit e Ministria e Brendshme, me objekt pavlefshmërinë e akteve administrative, urdhrave të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit për gradat policore etj.

I. Rrethanat e çështjes:

2. Me urdhrin nr. 319/5, datë 1.3.2006, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, pala paditëse Polikron Zyba është rikthyer në strukturat e Policisë së Shtetit, duke u emëruar në detyrën e shefit të seksionit të Policisë së Rendit dhe Sigurisë Publike në Komisariatin e Policisë Përmet, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Gjirokastrë dhe me urdhrin e ministrit të Brendshëm nr. 312, datë 17.2.2006, atij i është dhënë grada policore “k/inspektor”.

3. Këtë detyrë paditësi e ka kryer deri në datën 28.6.2006, pasi me urdhrin nr. 319/6, datë 27.6.2006 të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke pasur të njëjtën gradë, atë të



k/inspektorit ai është komanduar në detyrën e shefit të Komisarariatit të Policisë Përmet, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Gjirokastrë.

4. Me urdhrin nr. 319/6, datë 24.11.2006, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit është vendosur ndërprerja e komandimit të paditësit në detyrën e shefit të Komisarariatit të Policisë Përmet, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Gjirokastrë, duke urdhëruar që inspektor Polikron Zyba të emërohet në detyrën e shefit të sektorit (ai dhe për Qendrën Operative) në Seksionin e Policisë së Rendit dhe Sigurisë Publike në Komisarariatin e Policisë Përmet, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Gjirokastrë, duke i filluar të drejtat financiare nga data 5.12.2006. Në këtë urdhër, paditësi nuk pasqyrohet me gradën që kishte k/inspektor, por me gradën “inspektor”.

5. Me urdhrin nr. 142, datë 22.1.2007, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, pala paditëse Polikron Zyba, me gradën “inspektor”, është emëruar në detyrën e shefit të seksionit në Seksionin e Qendrës Operative dhe Emergjencës në Komisarariatin e Policisë nr. 6 Kombinat (qytet e fshat), pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë.

6. Me urdhrin nr. 142/1, datë 10.12.2007, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit e ka emëruar inspektor Polikron Zybën në detyrën e specialistit të informacionit (ai dhe për marrjen e kallëzimeve) në Komisarariatin e Policisë nr. 6, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, ndërsa me urdhrin nr. 732/1, datë 25.3.2008, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, paditësi me gradën “inspektor” është emëruar në detyrën e specialistit të informacionit (ai dhe për marrjen e kallëzimeve) në Seksionin e Kontrollit të Territorit në Komisarariatin e Policisë nr. 6, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë.

7. Duke qenë në këtë detyrë, me urdhrin nr. 43, datë 17.6.2008, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, është urdhëruar që paditësit n/inspektor Polikron Zyba, me detyrë specialist informacioni (ai dhe për marrjen e kallëzimeve) në Seksionin e Kontrollit të Territorit, në Komisarariatin e Policisë nr. 6 Tiranë, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë t'i jepet grada policore “n/komisar”.

8. Pala paditëse, duke mos qenë dakord me këtë akt administrativ, si dhe aktet administrative të mëparshme të nxjerra nga pala e paditur,

vetëm për sa i përket aplikimit të gradave “inspektor”, “n/inspektor” dhe “n/komisar” i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadinë me objektin e lartpërmendur.

II. Vendimet e gjykatave dhe arsyetimi i tyre:

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4937, datë 6.5.2013, ka vendosur:

Pranimin e kërkesëpadisë.

Anulimin pjesërisht të aktit administrativ, urdhrit nr. 319/8, datë 24.11.2006, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “inspektor” paditësit Polikron Zyba.

Anulimin pjesërisht të aktit administrativ, urdhrit nr. 142, datë 22.1.2007, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “inspektor” paditësit Polikron Zyba.

Anulimin pjesërisht të aktit administrativ, urdhrit nr. 142/1, datë 10.12.2007, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “inspektor”, paditësit Polikron Zyba.

Anulimin pjesërisht të aktit administrativ, urdhrit nr. 732/1, datë 25.3.2008, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “inspektor”, paditësit Polikron Zyba.

Anulimin pjesërisht të aktit administrativ, urdhrit nr. 5290/1, datë 7.9.2011, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “nënkomisar”, paditësit Polikron Zyba.

Anulimin pjesërisht të aktit administrativ, urdhrit nr. 43, datë 17.6.2008, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për sa i përket përcaktimit të gradës policore “n/inspektor”, paditësit Polikron Zyba.

Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, t'i njohë paditësit Polikron Zyba gradën policore “komisar” dhe të gjitha të drejtat që rrjedhin nga kjo gradë nga data 17.6.2008 e në vijim.

10. Gjykata e rrethit gjyqësor, ndër të tjera, arsyeton se:

.... Rezultoi e provuar se me urdhrin nr. 319/5, datë 1.3.2006, të Drejtorisë së Personel Formimit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Ministria e Brendshme, është



urdhëruar që paditësi Polikron Zyba të ripranohet në strukturat e Policisë së Shtetit dhe të emërohet në detyrën shëf seksioni në Seksionin e Policisë së Rendit dhe Sigurisë Publike, në Komisaratin e Policisë Përmet, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Gjirokastrë dhe me urdhrin e ministrit të Brendshëm nr. 312, datë 17.2.2006 i është dhënë grada policore “k/inspektor”.

Këtë detyrë paditësi e ka kryer deri në datën 28.6.2006, pasi me urdhrin nr. 319/6, datë 27.6.2006, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke pasur të njëjtën gradë “k/inspektor” është komanduar në detyrën shëf i Komisaratis të Policisë Përmet në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Gjirokastrë.

Pas disa muajsh në këtë detyrë, pala e paditur, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit me urdhrin nr. 319/8, datë 24.11.2006, “Për ndërprerjen e komandimit dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie”, ka urdhëruar që inspektori Polikron Zyba, me detyrë shëf seksioni në Qendrën Operative, në Seksionin e Policisë së Rendit dhe Sigurisë Publike, në Komisaratin e Policisë Përmet, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Gjirokastrë (aktualisht i komanduar në detyrën e shëfit të Komisaratis të Policisë Përmet), “Për ndryshimin e strukturës organike” t’i ndërpritet komandimi dhe të emërohet në detyrën shëf seksioni në Seksionin e Policisë së Rendit dhe Sigurisë Publike, në Komisaratin e Policisë Përmet, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Gjirokastrë, duke i filluar të drejtat administrative dhe financiare në datën 5.12.2006.

Në këtë akt, pala e paditur ka pasqyruar të ndryshuar gradën që mbante paditësi nga “k/inspektor” në “inspektor”.

Këtë detyrë, paditësi e ka kryer deri në datën 22.1.2007, pasi në bazë të urdhrin nr. 142, datë 22.1.2007, pala e paditur drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka urdhëruar që paditësi inspektor Polikron Zyba, me detyrë shëf seksioni, në Seksionin e Policisë së Rendit dhe Sigurisë Publike, në Komisaratin e Policisë Përmet, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Gjirokastrë, të transferohet dhe të emërohet në detyrën e shëfit të seksionit në Seksionin e Qendrës Operative dhe Emergjencës, në Komisaratin e Policisë nr. 6 Kombinat (qytet e fshat), në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë.

Në këtë detyrë paditësi ka shërbyer deri në datën 30.12.2007, pasi në bazë të urdhrin nr. 142/1, datë 10.12.2007, pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka urdhëruar që paditësi “inspektor” Polikron Zyba me detyrë shëf seksioni në Seksionin e Qendrës Operative dhe Emergjencës, në Komisaratin e Policisë nr. 6 Kombinat (qytet e fshat), në Drejtorinë e

Policisë së Qarkut Tiranë, “Për ndryshim të strukturës organike”, të emërohet në detyrën specialist informacioni dhe për marrjen e kallëzimeve, në Komisaratin e Policisë nr. 6 Tiranë, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë.

Në këtë detyrë, paditësi ka shërbyer deri në datën 31.3.2008, pasi në bazë të urdhrin nr. 732/1, datë 25.3.2008 “inspektor” Polikron Zyba, me detyrë specialist informacioni dhe për marrjen e kallëzimeve, në Seksionin e Policimit në Komunitet, në Komisaratin e Policisë nr. 6 Tiranë, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, “Për ndryshim të strukturës organike”, të emërohet në detyrën specialist informacioni (dhe për marrjen e kallëzimeve) në Seksionin e Kontrollit të Territorit, në Komisaratin e Policisë nr. 6 Tiranë, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë.

Me urdhrin nr. 43, datë 17.6.2008, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, është urdhëruar që paditësit n/inspektor Polikron Zyba, me detyrë specialist informacioni (dhe për marrjen e kallëzimeve) në Seksionin e Kontrollit të Territorit, në Komisaratin e Policisë nr. 6 Tiranë, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë” t’i jepet grada policore “n/komisar”.

Rezultoi e provuar në gjykim se paditësi e ka fituar gradën “k/inspektor”, në përputhje të plotë me ligjin nr. 8643, datë 20.7.2000, “Për gradat në Policinë e Shtetit”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 64, datë 2.2.2001, “Për inkuadrimin e gradave ushtarake, në gradat e Policisë së Shtetit dhe për përcaktimin e funksioneve, që do të ushtrohen sipas tyre”.

Ndërkohë që nga pala e paditur, në kundërshtim me gradën që paditësi e kishte përfutur “k/inspektor”, me urdhrin nr. 319/8, datë 24.11.2006, “Për ndërprerjen e komandimit dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie”, është konsideruar “inspektor” Polikron Zyba me detyrë shëf seksioni

Gjykata vlerëson se ky akt administrativ është i pavlefshëm për pjesën në të cilën ai përcakton gradën “inspektor” për paditësin, për faktin se është nxjerrë në kundërshtim të plotë me ligjin, kjo, pasi pala e paditur shpreh dhe njëkohësisht i ka caktuar paditësit gradën “inspektor”, ndërkohë që paditësi në momentin e nxjerrjes së këtij akti ka pasur gradën “krjeinspektor”, e cila i është dhënë me urdhër të ministrit të Brendshëm nr. 312, datë 17.2.2006 dhe nuk i është revokuar prej tij.

Në gjykim rezultoi se pala e paditur në nxjerrjen e urdhrin nr. 319/8, datë 24.11.2006 është bazuar në shkresën nr. prot., datë....., viti 2006, “Për caktimin e gradës policore të një punonjësi policie sipas funksionit organik që kryen”, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë, në bazë të së cilës është propozuar që k/inspektorit



Polikron Zyba, për arsye të mospërputhjes së gradës me funksionin organik, t'i caktohet grada korresponduese e funksionit “inspektor”.

Në momentin e nxjerrjes së urdhrin nr. 1964, datë 22.9.2006, paditësi vazhdon të ushtronte detyrën e shefit të Komisarariatit të Policisë Përmet (fakt i cili provohet me urdhrin nr. 319/6, datë 27.6.2006, “Për komandimin në detyrë të një punonjësi policie”), pra, detyrë dhe funksion që përputhet plotësisht me gradën “k/inspektor”, gradë të cilën ashtu sikurse rezultoi gjatë shqyrtimit të çështjes, paditësi e ka përfutur në përputhje të plotë me ligjin nr. 8643, datë 20.7.2000, “Për gradat në Policinë e Shtetit”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 64, datë 2.2.2001, “Për inkuadrimin e gradave ushtarake, në gradat e Policisë së Shtetit dhe për përcaktimin e funksioneve, që do të ushtrohen sipas tyre”.

Gjithashtu, rezultoi në gjykim se procedura e ndjekur nga pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për uljen në gradë të paditësit, nuk gjen mbështetje në asnjë dispozitë ligjore të parashikuar nga ligji i posaçëm “Për Policinë e Shtetit”, por edhe “Për gradat në Policinë e Shtetit”. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, nga pala e paditur nuk u paraqit urdhri nr. 1964, datë 22.9.2006.

Gjykata vlerëson se shkak i ligjor i pasqyruar nga pala e paditur në këtë propozim, se në rastin konkret kemi mospërputhjen e gradës me funksionin organik të paditësit, është, gjithashtu, i pabazuar në prova dhe në ligj.

Në rastin konkret rezultoi e provuar që paditësi ka qenë i inkuadruar në sistemin e gradave në Policinë e Shtetit dhe e ka fituar gradën “k/inspektor” në bazë të neneve 20 dhe 21, të ligjit nr. 8643, datë 20.7.2000 (urdhri i ministrit të Brendshëm nr. 312, datë 17.2.2006) dhe ka kryer detyrën e shefit të Komisarariatit të Policisë Përmet, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Gjirokastër dhe në asnjë moment paditësi nuk është subjekt i zbatimit dhe aplikimit të kësaj dispozite.

Për sa më lart, nuk u provua në gjykim se kemi mospërputhje të gradës me funksionin organik, pasi në momentin e nxjerrjes së këtyre akteve, paditësi ka pasur gradën policore “k/inspektor” dhe ka ushtruar detyrën e shefit të Komisarariatit të Policisë Përmet, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Gjirokastër, pra paditësi ka kryer funksione të cilat i përkasin pikërisht gradës “k/inspektor”.

Për këtë arsye, ulja e gradës së paditësit nga “k/inspektor” në “inspektor” nga pala e paditur, e pasqyruar në urdhrin nr. 319/8, datë 24.11.2006, “Për ndërprerjen e komandimit dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie”, ka ardhur në kundërshtim të plotë

me ligjin nr. 8643, datë 20.7.2000, “Për gradat në Policinë e Shtetit”, si dhe ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative”.

Në gjykim u relatua se paditësi është titulluar oficer policie në Ministrinë e Brendshme në muajin qershor të vitit 1992 dhe që prej kësaj kohe ka shërbyer në strukturat e Policisë së Shtetit deri në muajin qershor të vitit 1998. Siç e pasqyruam më lart, paditësi Polikron Zyba është pranuar dhe ka filluar të shërbejë në strukturat e Policisë së Shtetit me urdhrin nr. 319/5, datë 1.3.2006, të Drejtorisë së Personel Formimit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, ku edhe vazhdon aktualisht.

Gjykata vlerëson se në vijim të një paligjshmërie, konkretisht të uljes së gradës së paditësit nga “k/inspektor” në “inspektor” nga pala e paditur janë nxjerrë edhe disa urdhra të tjerë që janë të paligjshëm, për sa i përket gradës “inspektor” për paditësin, konkretisht urdhri nr. 142, datë 22.1.2007, urdhri nr. 142/1, datë 10.12.2007 dhe urdhri nr. 732/1, datë 25.3.2008.

Paditësi ka qenë në detyrën e shefit të seksionit deri në momentin e nxjerrjes së urdhrin nr. 142/1, datë 10.12.2007 dhe të drejtat administrative dhe financiare i kanë filluar në datën 31.12.2007. Pra, në momentin e miratimit dhe hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 803, datë 21.11.2007, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre”, paditësi ka ushtruar funksionin e shefit të seksionit. Pala e paditur nuk e ka vënë në dijeni paditësin lidhur me këto akte, ndërsa paditësi parashtrroi në gjykim se është vënë në dijeni të këtyre akteve vetëm në muajin dhjetor të vitit 2012 dhe sapo është njohur me përmbajtjen e tyre, i ka kundërshtuar, duke ndjekur fillimisht rrugën administrative dhe më tej rrugën gjyqësore.

Gjykata vlerëson se paditësi Polikron Zyba, në momentin e implementimit të gradave ka pasur të plotësuar të dyja kushtet për marrjen e gradës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 803, datë 21.11.2007, e para është funksioni që kryente në momentin e implementimit të gradave, paditësi ka qenë në detyrën e Shefit të Seksionit deri në momentin e nxjerrjes së urdhrin nr. 142/1, datë 10.12.2007 dhe të drejtat administrative dhe financiare i kanë filluar në datën 31.12.2007. Pra, në momentin e miratimit dhe hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 803, datë 21.11.2007, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre”, paditësi ka ushtruar funksionin e shefit të seksionit. Dhe, e dyta, paditësi plotëson kriterin e



vjetërsisë në shërbim prej 18 vite vjetërsi në punë si ushtarak, si dhe 7 vite vjetërsi në strukturat e policisë së shtetit.

Për sa i përket pretendimit të palës së paditur për parashkrimin e së drejtës së padisë, gjykata çmon se kërkimet për pavlefshmërinë absolute të aktit nuk i nënshtrohen parashkrimit.....

11. Gjykata e Apelit Tiranë (me të njëjtin arsyetim), me vendimin nr. 2362, datë 5.11.2013, ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 4937, datë 6.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

III. Ligji i zbatueshëm:

12. Neni 32 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se:

Padia mund të ngrihet:

a) për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur;

b) për vërtetimin e genies ose mosqenies së një marrëdhënie juridike ose një të drejte;

c) për njohjen e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike për paditësin.

13. Neni 116 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon se:

Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme:

a) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar;

b) kur akti administrativ është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore;

c) kur akti administrativ është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.

14. Neni 117/2 i Kodit të Procedurave Administrative, parashikon se:

Secila palë e interesuar mund të kërkojë që akti administrativ të shpallet absolutisht i pavlefshëm. Kërkesa në fjalë mund të bëhet në çdo kohë. Organi administrativ kompetent, me nismën e tij, mundet të deklarojë një akt administrativ absolutisht të pavlefshëm në çdo kohë.

15. Neni 33 i ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit”, parashikon se:

Sistemi i gradave përcakton hierarkinë, nivelet e administrimit, si dhe pasqyron marrëdhëniet ndërmjet funksioneve në Polici.

Sistemi i gradave, sipas këtij ligji, paraqitja, forma emërtimet dhe mbajtja e tyre janë e drejtë vetëm e Policisë.

16. Neni 39 i ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit”, parashikon se:

Tabela e funksioneve korresponduese për çdo gradë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

17. Neni 44 i ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit”, parashikon se:

Me përjashtim të nivelit zbatues, kur për shkak të ndryshimeve në strukturën organizative të Policisë shkurtohet numri i funksioneve organike për gradë, punonjësi i Policisë, që mban gradën ku do të kërkohej ulja, mund të kërkojë në mënyrë vullnetare uljen një gradë më poshtë, kur ka vende të lira.

Me krijimin e vendeve të lira për gradë, punonjësi i Policisë, që ka kërkuar uljen në gradë, rimerr brenda dy vjetësh gradën e mëparshme, sipas të njëjtit kriter të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

18. Neni 126/1 dhe 7, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit”, parashikon se:

1. Për kalimin nga sistemi i gradave të dhëna me ligjin nr. 8643, datë 20.7.2000, “Për gradat në Policinë e Shtetit”, në sistemin e gradave sipas këtij ligji, Këshilli i Ministrave nxjerr vendimin për përcaktimin e tabelës së funksioneve korresponduese për çdo gradë, si dhe ekuivalentimin e tyre, në bazë të nenit 39 të këtij ligji.

7. Punonjësi i Policisë ka të drejtë që, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni, të ankohet për gradën e marrë tek eprori i autoritetit që i ka dhënë gradën ose drejtpërdrejt në gjykatë.

19. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 803, datë 21.11.2007, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre”, parashikon se:

1. Funksionet korresponduese, për çdo gradë, sipas ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit”, si dhe ekuivalentimi i tyre me gradat e marra, sipas ligjit nr. 9643, datë 20.7.2000, “Për gradat në Policinë e Shtetit”, përcaktohen në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Në funksionet e këshilltarit të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, oficerit ndërlidhës ose pranë organizmave policorë ndërkombëtarë, mund të caktohet çdo punonjës policie, pavarësisht gradës që mban. Gjatë periudhës në këto funksione, punonjësi i policisë ka të drejtë të fitojë gradën pasardhëse, sipas kriterëve e procedurave të përcaktuara, i pakushtëzuar nga ekzistenca e funksioneve të lira për gradë.

3. Punonjësi personel i policisë merr gradën, që i korrespondon funksionit që kryen, vetëm nëse në çastin e kalimit në këtë sistem gradash, ka vjetërsi shërbimi jo më pak se:



a) 1 vit e 4 muaj për gradën “inspektor”, përfshirë edhe periudhën e shkollimit policor, me përjashtim të punonjësve të policisë, që janë në periudhën e provës;

b) 2 vjet e 8 muaj për gradën “kryeinspektor”;

c) 4 vjet për gradën “nënkomisar”, përfshirë edhe periudhën e shkollimit policor. Specialistëve të lartë të policisë në detyrë, u jepet grada “nënkomisar” edhe, nëse nga përlogaritja nuk plotësojnë vjetërsinë e shërbimit, përcaktuar në këtë shkronjë;

c) 6 vjet për gradën “komisar”;

d) 8 vjet për gradën “kryekomisar”;

dh) 10 vjet për gradën “drejtues”;

e) 12 vjet e 8 muaj për gradën “drejtues i parë”;

ë) 15 vjet e 4 muaj për gradën “zëvendësdrejtor i përgjithshëm”.

3/1 Pas kalimit në sistemin e ri të gradave, ngritja në gradë bëhet sipas afateve dhe kritereve të përcaktuara në nenin 41, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit”.

4. Ministri i Brendshëm merr masa për përfundimin e procesit të kalimit në sistemin e ri të gradave, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 126, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit” dhe në këtë vendim, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

5. Zbatimi i këtij vendimi nuk passjell efekte financiare në buxhetin e shtetit.

6. Vendimi nr. 64, datë 2.2.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për inkuadrimin e gradave ushtarake, në gradat e Policisë së Shtetit, dhe për përcaktimin e funksioneve, që do të ushtrohen sipas tyre”, të ndryshuar, nuk zbatohet për punonjësit e Policisë së Shtetit.

IV. Arsyetimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë:

20. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se, rekursi i paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit përmban shkaqe nga ato që parashikohen në ligj, prandaj vendimi nr. 4937, datë 6.5.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimi nr. 2362, datë 5.11.2013, i Gjykatës së Apelit Tiranë bëhen të cenueshëm.

21. Në bazë të urdhrit nr. 43, datë 17.6.2008, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, është urdhëruar që paditësit “n/inspektor” Polikron Zyba, me detyrë specialist informacioni (ai dhe për marrjen e kallëzimeve) në Seksionin e Kontrollit të Territorit, në Komisa-riatin e Policisë nr. 6, Tiranë, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë t’i jepet grada policore “n/komisar”.

22. Paditësi nuk ka qenë dakord me gradën e dhënë, duke pretenduar se në kohën kur ka hyrë në fuqi ligji nr. 9749, datë 4.6.2009, “Për Policinë e Shtetit” dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 803, datë 21.11.2007, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre”, ai ka pasur gradën “k/inspektor” dhe jo “inspektor”, siç e ka pasqyruar nëpër disa urdhra pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, prandaj sipas tabelës bashkëngjitur VKM-së së mësipërme atij i takonte që të merrte gradën policore “komisar” dhe jo “n/komisar”.

23. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pala paditëse Polikron Zyba ka pretenduar se ndaj tij nuk ka pasur ndonjë procedurë për ulje në gradë, gjë e cila kundërshtohet nga pala tjetër. Gjithashtu, dhe në çështje të tjera të kësaj natyre, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka konstatuar se ka pasur mjaft probleme me mënyrën se si ekuivalentohen gradat policore të fituara sipas ligjit nr. 8643, datë 20.7.2000 “Për gradat në policinë e shtetit” (i shfuqizuar), ose me ligje të tjera të mëparshme në sistemin e ri të gradave, pasi ka raste që grada që mbante oficeri i policisë me ligjin e vjetër nuk barazohet me gradën ekuivalente që pasqyrohet në tabelën e gradave që i bashkëngjitet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 803, datë 21.11.2007, siç është edhe rasti në gjykim.

24. Nga ana tjetër pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në gjyq ka mbajtur qëndrimin se përveç gradës korresponduese që pasqyrohet në tabelë duhet të shikohet edhe funksioni që kryente punonjësi i policisë në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 803, datë 21.11.2007, duke pretenduar që këto kritere duhet të plotësohen në të njëjtën kohë, pra ato duhet të jenë komulative.

25. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka ngritur pretendimin se kërkesëpadia e paraqitur nga pala paditëse është e parashkruar (parashkrimi shues), sepse ajo është ngritur pas më shumë se pesë vitesh nga dalja e urdhrit të fundit që kundërshtohet (jashtë afatit ligjor), në një kohë kur paditësi ka punuar për një kohë të gjatë në polici me gradën e re, i cili pretendon se



nuk ka pasur dijeni për urdhrat e nxjerrë nga pala e paditur. E njëjta situatë është vënë re edhe në çështje të ngjashme të ardhura për gjykim përpara Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

26. Me vendimin e datës 19.1.2016, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi zhvilloi seancën gjyqësore, dëgjoi përfaqësuesen e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, duke qenë se edhe qëndrimet e praktikës gjyqësore nuk kanë qenë të njëjta për çështje të ngjashme, duke u bazuar në nenin 14/c, të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar, dhe nenin 481 të K.Pr.Civile vendosi ta dërgojë çështjen për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat duhet të zgjidhin çështjet e mëposhtme:

1. *Cilat duhet të jenë kriteret ligjore që duhet të merren parasysh për caktimin e gradës së re, në rastin e ekuivalentimit të gradave policore të dhëna sipas ligjit nr. 8643, datë 20.7.2000, “Për gradat në Policinë e Shtetit” (i shfuqizuar), ose me ligje të tjera të mëparshme me gradat e reja policore, të parashikuara nga ligji nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit” dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 803, datë 21.11.2007, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre”?*

2. *Nëse punonjësi i policisë, të cilit i është dhënë një gradë më e ulët se grada që i korrespondonte atij në tabelën e gradave, ka vazhduar të punojë, duke u paguar me gradën e re, të cilën ai e kundërshton, a do të konsiderohet ky fakt si marrje dijeni për aktin administrativ me të cilin është bërë ekuivalentimi i gradës policore?*

27. Në rekurs dhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ndërmjet të tjera pretendon se e drejta e paditësit për të paraqitur kërkesëpadi përpara gjykatës është e parashkruar (parashkrimi shues), sepse kërkesëpadia është paraqitur në gjykatë jashtë afatit të parashikuar në ligj, ndërsa për sa i përket ligjit material, pala e paditur pretendon se, gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit nuk e kanë zbatuar drejtë atë, pasi ato nuk kanë marrë parasysh funksionin që kryente paditësi Polikron Zyba në momentin e ekuivalentimit të gradave.

28. Në nenin 126, pika 7, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit” është parashikuar se: Punonjësi i Policisë ka të drejtë që, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni, të ankohet për gradën e marrë tek eprori i autoritetit që i ka dhënë gradën ose drejtpërdrejt në gjykatë, ndërsa në nenin 18, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, parashikohet se: Padia kundër veprimit administrativ paraqitet në gjykatë brenda 45 ditëve. Ky afat fillon nga data e njoftimit, sipas mënyrës së përcaktuar në ligj, të aktit administrativ, në rastet kur ky akt ankimohet drejtpërdrejt në gjykatë... Megjithëse dy dispozitat ligjore që cituam më sipër kanë kundërshti me njëra-tjetrën, këtë kontradiktë e ka zgjidhur më së miri ligji nr. 49/2012 në dispozitat kalimtare të tij, kur në nenin 72/3 ai thotë: Të gjitha afatet për paraqitjen e padisë ndaj aktit administrativ apo veprimit tjetër administrativ janë 45 ditë, me përjashtim të rasteve kur në ligje të veçanta është parashikuar ndryshe. Meqenëse neni 127/7, i ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007 (ligji i specifik) është i zbatueshëm në rastin objekt shqyrtimi, atëherë paditësi Polikron Zyba ka pasur të drejtë që brenda 30 ditëve nga marrja dijeni t'i drejtohej me ankim eprorit të organit që i ka dhënë gradën ose drejtpërdrejt në gjykatë.

29. Kërkesëpadia është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 4.1.2013, ndërsa aktet administrative që kundërshtohen prej paditësit Polikron Zyba janë nxjerrë nga pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në datat 24.11.2006, 22.1.2007, 10.12.2007, 25.3.2008, 17.6.2008 dhe 7.9.2011. Fillimisht paditësi ka kërkuar kundërshtimin dhe shfuqizimin e akteve administrative, por në datën 18.4.2013 ai ka depozituar në gjykatën e shkallës së parë një kërkesë me shkrim për shtimin dhe saktësimin e objektit të padisë, konform nenit 185 të K.Pr.Civile, duke kërkuar anulimin e akteve administrative të mësipërme (të disave pjesërisht), kërkesë e cila me vendim të ndërmjetëm është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

30. Në nenin 126, pika 7, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit” është përdorur shprehja “nga marrja dijeni”, pra vetë



ligji specifik nuk parashikon ndonjë mënyrë të veçantë për njoftimin e punonjësit të policisë në lidhje me gradën e re të ekuivalentuar. Gjithashtu, në pikat 4 dhe 5 të po kësaj dispozite ligjore, ligjvënësi ka parashikuar se për kalimin nga sistemi i vjetër i gradave në sistemin e ri të gradave ngrihen komisione kalimtare, të cilat kanë për detyrë që të shqyrtojnë dokumentacionin dhe të bëjnë propozime përpara organeve që kanë kompetencën për dhënien e gradave. Ligjvënësi ka parashikuar se funksionimi, organizimi dhe procedurat që duhet të ndiqen nga komisionet kalimtare përcaktohen me urdhër të ministrit. Këto komisione përfundojnë së funksionuari me përfundimin e procesit të ekuivalentimit të gradave.

31. Pra, ligji specifik që rregullon çështjen në gjykim nuk përcakton ndonjë rregull të veçantë për të treguar mënyrën se, si duhet të njoftohet punonjësi i policisë së shtetit të cilit i është ekuivalentuar grada policore, por e lidh fillimin e afatit të ankimit me marrjen dijeni të palëve të interesuara. Gjithashtu, edhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 803, datë 21.11.2007, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre”, parashikon vetëm gradat korrespo-nduese me gradat e vjetra që mbanin punonjësit e policisë dhe funksionet që iu përkasin gradave të reja policore, duke mos parashikuar ndonjë rregull të veçantë për mënyrën e njoftimit dhe ankimin që mund të bëhet ndaj gradave të dhëna.

32. Nga ana tjetër, komisionet kalimtare, sipas nenit 126/4 dhe 5, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, kanë për detyrë vetëm që të shqyrtojnë dokumentet e punonjësve të policisë dhe t’i paraqesin propozimet, drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, i cili është organi administrativ i ngarkuar me ligj për dhënien e gradave policore, por ligji nuk parashikon se si duhet të bëhet njoftimi i këtij akti administrativ, në mënyrë që punonjësit të policisë t’i jepet mundësia që të kundërshtojë gradën e marrë nëse ai e konsideron atë të padrejtë. Të ndodhur në këto rrethana edhe në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vlerësojnë se duhet marrë në analizë i gjithë korpusi legjislativ që ka të bëjë me njoftimet dhe marrjen e dijenisë efektive të palëve pjesëmarrëse në procesin administrativ.

33. Në nenet 56 dhe 57 të Kodit të Procedurave Administrative janë parashikuar detyrimi për të njoftuar aktet administrative dhe përjashtimi nga ky detyrim. Aktet administra-tive që kundërshtohen nga paditësi prekin të drejtat e pretenduara prej tij, prandaj në kuptim të nenit 56/c të K.Pr.Administrative dhe neneve 42 dhe 44 të Kushtetutës ato duhej t’i njoftoheshin atij nga pala e paditur. Sipas nenit 57 të K.Pr.Administrative, administrata publike nuk ka për detyrë që të njoftojë aktin administrativ kur ai u komunikohet gojarisht në prani të palëve të interesuara, ose kur pala merr pjesë në procedimin administrativ dhe ka njohuri të plota në lidhje me aktin. Nga gjykimet në shkallë të parë dhe në gjykatën e apelit nuk rezulton e provuar që pala e paditur t’i ketë njoftuar gojarisht paditësit, aktet administrative të kontestuara prej tij, ose ky i fundit të ketë marrë pjesë në procedimin administrativ për nxjerrjen e tyre.

34. Përmbajtja e dispozitave të mësipërme ligjore është e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me përmbajtjen e aktit administrativ individual, të parashikuar nga neni 106 i K.Pr.Administrative, si dhe kuptimi që iu jep ligji palëve të interesuara, të parashikuara nga nenet 44 dhe 45 të këtij Kodi. Detyrimi i organit të administratës publike që ka nxjerrë aktin administrativ për të njoftuar palët e interesuara për përmbajtjen e tij, është një detyrim që rrjedh nga e drejta kushtetuese dhe KEDNJ-ja, me qëllim për të respektuar procesin e rregullt ligjor (neni 42/2 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i KEDNJ-së).

35. Në nenin 60 të K.Pr.Administrative janë parashikuar mënyrat e njoftimeve, të cilat mund të bëhen me anë të shërbimit postar, personalisht, me telegram, telefon, teleks ose faks në rastet e urgjencës, me afishim publik të njoftimit etj. Në rastin në gjykim ligji specifik hesht në lidhje me këtë çështje, duke mos thënë asgjë se si bëhet njoftimi i punonjësit të policisë për aktin administrativ me anë të të cilit atij i është ekuivalentuar grada policore, duke thënë vetëm që afati i ankimit ndaj aktit administrativ fillon nga marrja dijeni e personit të interesuar, kështu që për njoftimin e aktit administrativ, pala e paditur duhet të zbatonte ndonjërin nga mënyrat e njoftimit, të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative.



36. Në të njëjtën linjë me parashikimet e nenit 56 e vijues të K.Pr.Administrative ka qenë edhe përmbajtja e nenit 328 të K.Pr.Civile, i shfuqizuar me ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i cili afatin e ankimit ndaj një akti administrativ e lidhte me ditën shpalljes ose të njoftimit të vendimit të organit më të lartë administrativ kur rruga administrative e ankimit ishte e detyrueshme, ose nga dita e shpalljes ose njoftimit të tij, kur ligji e lejonte ankimin e drejtpërdrejt në gjykatë. Në rastin në gjykim, ligji specifik ka një qëndrim dualist (të dyfishtë), pasi ai lejon ankimin ose te titullari i organit që ka nxjerrë aktin administrativ ose drejtpërdrejt në gjykatë, duke parashikuar një afat të njëjtë me afatin që parashikonte edhe neni 328 i Kodit të Procedurës Civile (i shfuqizuar).

37. Kodi i Procedurës Civile ka hyrë në fuqi në datën 1.6.1996 dhe ai është miratuar përpara Kodit të Procedurave Administrative, i cili është shpallur nga Presidenti i Republikës, me dekreten nr. 2387, datë 7.6.1999 dhe ka hyrë në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare. Në nenin 328 të K.Pr.Civile nuk rezulton që të ketë pasur ndryshime deri në shfuqizimin e tij, prandaj Kodi i Procedurave Administrative jo vetëm që ka ruajtur parimet e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, por ai i ka zhvilluar edhe më tej konceptet që lidhen me njoftimin, duke pasur në disa dispozita ligjore parashikime, të tilla si: kur duhet të njoftohen aktet administrative individuale, përjashtimi nga njoftimi, afati, mënyra e njoftimit etj.

38. Në korpusin tonë legjislativ ka edhe ligje të veçanta, të cilat shprehen se njoftimi i palëve është i domosdoshëm, sidomos atëherë kur ai lidhet me ezaurimin (ndjekjen) e rrugës administrative të ankimit, sepse këto raste janë të lidhura me afate shumë të shkurtra kohore dhe është shumë e nevojshme që njoftimi që u bëhet palëve të interesuara nga organi administrativ që ka nxjerrë aktin të tregojë organin më të lartë administrativ, të cilit duhet t’i drejtohet ankimi administrativ. Kështu ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe ligji nr. 8449, datë 27.1.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, parashikojnë se, kur organet

tatimore ose doganore nxjerrin njoftim vlerësime tatimore ose doganore dhe në rastin vendosjes së gjobave të ndryshme prej tyre, ato janë të detyruara që t’u dërgojnë njoftim subjekteve të interesuara për aktet administrative, të cilat mund të jenë objekt i kontestit administrativ, duke iu dërguar atyre aktin administrativ dhe duke treguar organin administrativ të cilit i drejtohet ankimi. Mungesa e një njoftimi të tillë i jep të drejtë palës së interesuar që ta ankojë vendimin e organit administrativ pavarësisht të kalimit të afateve të parashikuara në ligj.

39. Ndërsa në rastet kur ligji i veçantë parashikon mundësinë e ankimit të drejtpërdrejtë në gjykatë, pra çështja i përket juridiksionit gjyqësor, njoftimi që u bëhet palëve të interesuara mund të mos i përmbajë hollësisht të dhënat e mësipërme, por ankimi në gjykatë bëhej në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 328, të Kodit të Procedurës Civile, i shfuqizuar tashmë me ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, në të cilin parashikohej afati i ankimit dhe e drejta e paraqitjes së padisë në gjykatë kundër vendimit të organit më të lartë administrativ, vendimit të organit që ka nxjerrë aktin në rastin e ankimit të drejtpërdrejtë në gjykatë, vendimit të organit administrativ që nuk ka nxjerrë aktin ose nuk e ka marrë në shqyrtim atë brenda afatit të parashikuar në ligj.

40. Ndër aktet ndërkombëtare që lidhen me njoftimet e palëve të interesuara mund të përmendim Konventën Evropiane “Për llogaritjen e afateve kohore”, miratuar në datën 16.5.1972, e cila nuk rezulton që të jetë ratifikuar nga vendi ynë dhe Rregulloren (EEC Euratom) nr. 1182/71, të miratuar në datën 3.6.1971. Kjo Konventë ka si qëllim të unifikojë në këtë fushë ligjet e vendeve anëtare të Këshillit të Evropës dhe ajo merret kryesisht me momentin se kur fillon të ecë afati i ankimit për subjektet e interesuara, i cili njihet me termin *dies a quo* dhe momentin se kur skadon afati i ankimit, i cili njihet me termin *dies ad quem*. Megjithëse ky akt ndërkombëtar nuk bën pjesë në sistemin e brendshëm juridik të vendit tonë, për shkak të mos ratifikimit të saj (neni 122/1 i Kushtetutës), gjithsesi, Konventa mban një qëndrim të ngjashëm me legjislacionin shqiptar, duke i



mëshuar faktit se, fillimi dhe mbarimi i afateve të ankimit janë të lidhura drejtpërdrejt me njoftimin e palëve (marrjen e dijenisë efektive të tyre). Të njëjtin qëndrim mban edhe rregullorja që përmendëm më sipër, e cila përcakton normat e aplikueshme për periudhat kohore, datat dhe afatet, të cilat zbatohen për aktet e Këshillit ose Komisionit, të miratuar apo për t'u miratuar në bazë të Traktatit që krijon Komunitetin Ekonomik Evropian apo të Traktatit që krijon Komunitetin Evropian të Energjisë Atomike. Sipas nenit 3/1 të kësaj rregulloreje nëse një periudhë kohore e shprehur në javë, muaj apo vite, duhet të llogaritet, duke u nisur nga momenti në të cilin verifikohet një ngjarje apo kryhet një veprim, dita në të cilën verifikohet kjo ngjarje apo kryhet ky akt nuk llogaritet në periudhën në fjalë, që do të thotë se afatet e mësipërme të ankimit lidhen ngushtësisht me momentin e marrjes dijeni të palëve të interesuara.

41. Paditësi Polikron Zyba ka ankuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë urdhrin nr. 319/8, datë 24.11.2006, të nxjerrë nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, duke e konsideruar atë si një akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, i cili ka sjellë si pasojë pavlefshmërinë absolute të akteve administrative që vijnë më pas (të disave pjesërisht). Duhet theksuar se kur pala e paditur ka nxjerrë urdhrin e mësipërm nuk ka qenë i miratuar ligji nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit,” i ndryshuar, prandaj në këtë rast gjejnë zbatim ligji nr. 8643, datë 20.7.2000, “Për gradat në Policinë e Shtetit” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 64, datë 2.2.2001, “Për inkuadrimin e gradave ushtarake, në gradat e Policisë së Shtetit dhe për përcaktimin e funksioneve, që do të ushtrohen sipas tyre”.

42. Në nenin 26/8, të ligjit nr. 8643, datë 20.7.2000, “Për gradat në Policinë e Shtetit” është parashikuar rasti i përshtatjes së gradës me funksionin, që do të thotë se kur grada që mban punonjësi i policisë nuk përputhet me gradën që parashikon funksioni që ai kryen, punonjësit të policisë i bëhet një vlerësim i punës për dy vitet e fundit dhe kur ai rezulton me një vlerësim shumë të mirë, atëherë dërgohet në një detyrë, në mënyrë që të përputhet grada me funksionin, përputhje e cila sipas kësaj dispozite ligjore është e detyrueshme për çdo rast.

43. Në nenin 38, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit” është parashikuar se, mënyra e paraqitjes, forma dhe ndërtimi i gradave miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, pas zhvillimit të një procesi konkurrimi për dizënjimin e tyre, që do të thotë se, pasi pranë palës së paditur, Drejtorisë së Policisë së Shtetit zhvillohet një konkurs ku punonjësit e policisë njihen me të gjitha gradat policore, këto grada vendosen në kostumet (veshjet) e tyre, prandaj pala paditëse duke i mbajtur gradat e marra në veshjen e tij nuk mund të pretendojë se, nuk kishte marrë dijeni se çfarë grade mbante dhe nëse nuk ishte dakord me të, i ka pasur të gjitha mundësitë që të kundërshtonte gradën në përputhe të plotë me parashikimet ligjore.

44. Në nenin 88/2, 3 të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit” është parashikuar se, paga e punonjësit të policisë caktohet sipas gradës dhe funksionit që ai ka fituar. Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se, paga e punonjësit të policisë përbëhet nga paga bazë që është paga për gradë dhe nga shtesat mbi pagën bazë për kushtet e vendit punës, shërbimit, kualifikimet etj. Ligjvënësi ka përcaktuar si kriter kryesor për caktimin e pagës së punonjësit të policisë gradën e tij. Gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit ka rezultuar e provuar se, paditësi Polikron Zyba ka punuar për rreth dy vjet me gradën inspektor, duke marrë edhe pagën që i përkiste kësaj grade, ndërsa nga data 17.6.2008 e në vazhdim, ai ka mbajtur gradën e re n/komisar, duke marrë edhe pagesën që i përket kësaj grade, prandaj dijenia e tij për ekzistencën e akteve administrative që kundërshton ka qenë e plotë.

Duke arsyetuar si më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në këtë përfundim unifikues: Kur punonjësi i Policisë së Shtetit ka mbajtur dhe është paguar për gradën policore të cilën më pas ai e kundërshton, konsiderohet se ai ka marrë dijeni për gradën që kundërshtohet.

45. Përderisa Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk i hynë shqyrtimit të meritës (themelit) të çështjes, për shkak se ato arrijnë në konkluzionin se e drejta e paditësit Polikron Zyba për të paraqitur kërkesëpadi në



gjykatë është e parashkruar (parashkrimi shues), pasi ajo është paraqitur tej afateve të parashikuara në ligj, atëherë pika e parë e parashtruar për unifikim nga Kolegji Administrativ i kësaj gjykate në vendimin e datës 19.1.2006, mbeti e pa unifikuar.

46. Për sa i përket zgjidhjes së çështjes konkrete e theksuam edhe më sipër se, fillimisht paditësi Polikron Zyba ka kërkuar pavlefshmërinë relative të akteve administrative të nxjerra nga pala e paditur, por gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në gjykatën e shkallës së parë ai i ka paraqitur një kërkesë më shkrim për ndryshimin dhe saktësimin e objektit të padisë, duke u bazuar në parashikimet e nenit 185 të K.Pr.Civile, kërkesë, e cila është pranuar nga gjykata, duke vazhduar gjykimin me objekt pavlefshmërinë absolute të akteve administrative (të disave pjesërisht), pasi një kërkim i tillë në bazë të nenit 18, pika 8, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin e dhe funksionimin e gjykatave administrative” dhe nenit 117/2 të K.Pr.Administrative mund të paraqitet në çdo kohë (mbi pavlefshmërinë absolute të akteve administrative nuk shtrin efektet e tij parashkrimi shues).

47. Kolegjet Civile dhe Administrative të Gjykatës së Lartë kanë pasur qëndrime të konsoliduara në lidhje me pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, duke theksuar që për kundërshtimin e saj në gjykatë nuk është e nevojshme që më parë të ndiqet rruga administrative e ankimit, si dhe kërkesëpadia për konstatimin absolutisht të pavlefshëm të aktit administrativ mund të ngrihet në çdo kohë, pasi kjo lloj pavlefshmërie nuk i nënshtrohet parashkrimit shues, por këto kolegje kanë theksuar në mjaft raste se, kur gjykata e shkallës së parë ose gjykata e apelit gjykojnë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, ato duhet t’i përmbahen me rigorizitet vetëm parashikimeve që bën neni 116 i K.Pr.Administrative.

48. Dispozita ligjore e mësipërme parashikon vetëm tri raste të pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, të cilat janë: akti nxirret nga një organ i paidentifikuar, akti nxirret në kapërcim të kompetencave që i jep ligji organit administrativ dhe kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji. Në

rastin në shqyrtim organi administrativ është një organ i identifikuar dhe ai ka vepruar brenda kompetencave që i jep ligji, pasi si ulja në gradë ashtu edhe ekuivalentimi i saj kanë qenë në kompetencë të palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Gjithashtu, aktet administrative të kontestuara nga paditësi kanë formën e kërkuar nga ligji, pasi urdhrat me të cilët janë dhënë gradat janë në formë shkresore.

49. E vetmja gjë që mbeti pa analizuar është zbatimi i procedurës së kërkuar nga ligji nga ana e organit administrativ. Në ligjin nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, dhe në ligjin nr. 8643, datë 20.7.2000, “Për gradat në Policinë e Shtetit” janë parashikuar se, për verifikimin e gradave gjatë ekuivalentimit të tyre ngihen komisione kalimtare, të cilat verifikojnë dokumentet dhe bëjnë propozimin përpara organeve kompetente për dhënien e gradave. Ligjvënësi nuk ka parashikuar ndonjë rregull të veçantë për pjesëmarrjen e personave të interesuar në procedim, por është mjaftuar me parashikimin se, punonjësi i policisë, i cili pretendon se i është shkëlur e drejta në dhënien e gradës mund të bëjë ankim administrativ ose gjyqësor brenda 30 ditëve nga marrja dijeni, prandaj në rastin në shqyrtim edhe procedura e nxjerrjes së akteve administrative është zbatuar në përputhje të plotë me ligjin dhe, për rrjedhojë, nuk ndodhemi përpara asnjë rasti të parashikuar nga neni 116 i K.Pr.Administrative.

50. Gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit arsyetojnë se, ndodhemi përpara pavlefshmërisë absolute të akteve administrative, pa bërë asnjë referim në nenin 116 të K.Pr.Administrative, duke thënë se, pas largimit të paditësit nga detyra e shefit të Komisarariatit të Policisë Përmet, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Gjirokastrë në vitin 2006, ai i kishte të gjitha kushtet dhe kriteret ligjore që të mbante gradën k/inspektor, pretendim, i cili ka të bëjë me pavlefshmërinë relative të akteve administrative, së cilës Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk mund t’i hyjnë për shkak të parashkrimit të së drejtës së paditësit Polikron Zyba për të paraqitur padi në gjykatë, pasi ka kaluar afati 30-ditor i ankimit.

51. Për të gjitha këto që thanë më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë



në përfundimin se rekursi i paraqitur nga pala e paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është i bazuar në ligj, prandaj si i tillë ai duhet të pranohet dhe për rrjedhojë vendimi nr. 4937, datë 6.5.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimi nr. 2362, datë 5.11.2013, i Gjykatës së Apelit Tiranë duhet të ndryshohen, duke u vendosur rrëzimi i kërkesë-padisë. Për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore ky vendim duhet të dërgohet për t'u botuar në Fletoren Zyrtare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke u bazuar në nenin 147/6 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 63/dh të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”,

VENDOSËN:

Ndryshimin e vendimit nr. 4937, datë 6.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimit nr. 2362, datë 5.11.2013, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe rrëzimin e kërkesë-padisë.

Ky vendim është unifikues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Xhezair Zaganjori (kryesues), Ardian Nuni, Ardian Dvorani, Aleksandër Muskaj, Majlinda Andrea, Arjana Fullani, Evelina Qirjako, Guxim Zenelaj, Andi Çeliku, Medi Bici, Edmond Islamaj, Shkëlzen Selimi, Artan Zeneli, Admir Thanza, Tom Ndreca, Artan Broci

Anëtarë kundër për unifikimin: Mirela Fana

MENDIM PAKICE

1. Unë gjyqtarja Mirela Fana, jam gjyqtare në pakicë në lidhje me arritjen e përfundimit njësores në vendimin nr. 1, datë 29.2.2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku shumica ka vendosur se: **“Kur punonjësi i Policisë së Shtetit, ka mbajtur dhe është paguar për gradën policore të cilën më pas ai e kundërshton, konsiderohet se ai ka marrë dënimin për gradën që kundërshtohet.”**

2. Si gjyqtare në pakicë, jam e mendimit se, çështja objekt gjykimi është një çështje e një

natyre të tillë, e cila nuk përbën një nga rastet e shqyrtimit në Kolegje të Bashkuara me qëllim njësimin apo ndryshimin e praktikës gjyqësore.

3. Fillimisht, sikurse ka rezultuar në çështjen gjyqësore objekt unifikimi, në zbatim të ligjit specifik të aplikueshëm, e konkretisht, nenit 126, pika 7, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit”, është parashikuar se punonjësi i policisë ka të drejtë që, brenda 30 ditëve nga marrja dëni, të ankohet për gradën e marrë tek eprori i autoritetit që i ka dhënë gradën ose drejtpërdrejt në gjykatë.

4. Në analizë të parashikimit të mësipërm ligjor, i gjithë diskutimi objekt unifikimi është përqendruar në pyetjen nëse, në mungesë të vërtetimit të komunikimit të aktit për gradën e akorduar, por në kushtet kur rezulton se nga mënyra efektive e aplikimit të gradave dhe vizualizimit të tyre në uniformën përkatëse, si dhe në kushtet e efekteve përkatëse financiare të një grade policore, mund të prezumohet marrja dëni për aktin e ndryshimit të gradës.

5. Shumica e Kolegjeve të Bashkuara ka konkluduar se, një rast i tillë do të konsiderohet si marrje dëni për ndryshimin e gradës policore, për efekt të përlllogaritjes së afatit të parashkrimit të padisë për kundërshtimin e aktit administrativ mbi ndryshimin e kësaj grade.

6. Vlerësoj se nga pikëpamja përmbajtësore jam dakord me një konkluzion të tillë ligjor, por ky konkluzion nuk përbën në vetvete një nga ato raste për të cilat nevojitet, si investimi i Kolegjeve të Bashkuara për arritjen e një qëndrimi të unifikuar, po ashtu edhe arritja në një përfundim të tillë njësores.

7. Në mbështetje të qëndrimit të mësipërm, çmoj fillimisht se, referuar legjislacionit aktual i cili rregullon rastet e dërgimit të një çështjeje për gjykim në Kolegjet e Bashkuara me qëllim njësimin apo ndryshimin e praktikës gjyqësore, në kontekstin e çështjes konkrete, nuk gjendemi përpara njërit prej këtyre rasteve. Në këtë përfundim arrihet, pas një interpretimi sintetik e të harmonizuar të të gjithë kuadrit ligjor që rregullon dërgimin e çështjes për gjykim pranë Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

8. Konkretisht, neni 141/2 i Kushtetutës parashikon se: **“Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të**



caktuara gjyqësore.” Në respektim të sa më sipër, ligji specifik nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 14 të tij parashikon se çështjet që gjykohen në Kolegjet e Bashkuara janë: “...a) rastet e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin e Procedurës Penale; b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; c) kërkesat për njehsimin dhe ndryshimin e praktikës; ç) raste të tjera të parashikuara me ligj”.

9. Po ashtu, duke iu referuar nenit 481 të Kodit të Procedurës Civile, Kryetari i Gjykatës së Lartë mund të vendosë që gjykata të shprehet në Kolegje të Bashkuara për rekurse të paraqitura nga palët, për të cilat ka praktika të ndryshme të mëparshme në kolegjet e thjeshta. Sikurse qartazi rezulton nga dispozita e mësipërme, një prej rasteve të investimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me qëllim unifikimin apo ndryshimin e praktikës gjyqësore, është pikërisht rasti i ekzistencës për të njëjtin problem ligjor, të praktikave të ndryshme të mëparshme nga kolegjet e thjeshta.

10. Në vijim të këtij argumentimi, vlerësoj se në rastin konkret, nuk ndodhemi përpara praktikave të ndryshme të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë, pasi vetë Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka konstatuar paraprakisht ekzistencën efektive të këtyre praktikave nga ana e Kolegjeve të thjeshta. Në këtë mënyrë, sipas vetë përcaktimit të shumicës së Kolegjeve të Bashkuara, qëllimi i kalimit të çështjes objekt gjykimi për unifikim, ka qenë fakti se, sipas kësaj shumice “...ligji specifik që rregullon çështjen në gjykim, nuk përcakton ndonjë rregull të veçantë për të treguar mënyrën se si duhet të njoftohet punonjësi i Policisë së Shtetit të cilit i është ekuivalentuar grada policore, por e lidh fillimin e afatit të ankimit me marrjen dijeni të palëve të interesuara.”.

10.1 Ndryshe nga ky përcaktim, jam e mendimit se, ligji ekzistues nuk ka mangësi në këtë drejtim, sa kohë që edhe në mungesë të një përcaktimi të shprehur mbi marrjen dijeni të një akti administrativ, në një proces gjyqësor do të mund të zbatohen mjetet përkatëse procedurale të të provuarit, për të identifikuar nëse është marrë efektivisht dijeni për këtë akt nga ana e palës së interesuar.

10.2 Po ashtu, edhe në rast se do të gjendeshim përpara mangësisë së ligjit ekzistues, sikurse arsyeton shumica e Kolegjeve të Bashkuara, jam e mendimit se, si evidentimi i këtyre mangësive, po ashtu edhe identifikimi i faktit që potencialisht interpretimi i këtij ligji në gjendjen ekzistuese mund të krijojë hapësirë për dykuptimësi, nuk përbëjnë shkaqe ligjore për të shqyrtuar një çështje në Kolegje të Bashkuara për unifikimin apo ndryshimin e praktikës gjyqësore.

11. Arsyetimi i mësipërm gjen mbështetje ligjore edhe në faktin se, parashikimi i ekzistencës së praktikave të ndryshme të Kolegjeve të thjeshta për të njëjtin problem ligjor, si kusht për ndërmarrjen e iniciativës për shqyrtimin e një çështjeje në Kolegje të Bashkuara, përbën një parim i cili synon të mbrojë Gjykatën e Lartë ndaj prirjes për “ndërrhyrje” të një natyre legjislativë, duke identifikuar qartazi ndarjen ndërmjet së drejtës ekskluzive të pushtetit ligjvënës për të bërë ligj dhe së drejtës ekskluzive të pushtetit gjyqësor për të interpretuar ligjin.

12. Thënë kjo, jam e mendimit se qëndrimi i shumicës në vendimin e mësipërm të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, evidenton qartazi rrezikun e ndërrhyrjes së palegjitimuar të Gjykatës së Lartë në pushtetin legjislativ, ku gjykata, edhe pse në rastin konkret nuk ka pasur mangësi në ligjin specifik të aplikueshëm, në mungesë të prerogativave kushtetuese për të krijuar apo plotësuar një normë, konkludon efektivisht në një përmbajtje të amenduar të ligjit ekzistues.

13. Për sa më sipër, vlerësoj se, pavarësisht përmbajtjes së konkluzionit të arritur në përfundimin njësoj, vetë dërgimi i çështjes për shqyrtim në Kolegje të Bashkuara, me qëllim unifikimin apo ndryshimin e praktikës gjyqësore, nuk është kryer në kushtet e kuadrit ligjor specifik që rregullon pikërisht këtë procedurë, e konkretisht nenit 14, të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe nenit 481 të Kodit të Procedurës Civile.

GJYQTARE
Mirela Fana

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin numër 12-2016-630/238, datë 25.4.2016, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Naxhi Caca, duke caktuar si kujdestare apo përfaqësuese ligjore të tij, bashkëshorten e tij, kërkuesen Xhemaile Caca.

KËRKESË

Shtetasja Kozeta Zguro, e bija e Andonit dhe e Sofias, e datëlindjes 8.10.1963, lindur në Korçë dhe banuese në Polenë, kërkon pranë gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj, shtetasit Dhimitraq Zguro.

KËRKUES
Kozeta Zguro

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 392 lekë